

Uniteti Islam

sipas

Imam Khomeinit

Tiranë, 2018

Titulli: **Uniteti Islam sipas Imam Khomeinit**

E përktheu: **Vullnet Merja**

Recensues: **Sabrie Feza**

E redaktoi: **Esat Bunguri**

E korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بسم الله الرحمن الرحيم

PARATHËNIE

Falënderimet dhe lëvdatat më të sinqerta ia dedikojmë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të Dërguarin, Mëshirë për njerëzimin dhe unifikues i fjalës së të dobtëve dhe të të varfërve. Paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi antarët e pastër të familjes së tij të nderuar, mbi ata që janë argument për të gjithë pjesën tjetër të njerëzimit.

Kjo është njëra nga dëshirat më të mëdha që i ka mbushur me jetë shpresat e myslimanëve. Uniteti është rruga më e përshtatshme, madje rruga e vetme për t'u përballur me planet e armiqve të myslimanëve. Uniteti islam është modeli më përfaqësues i politikave tona. Ai është Islami vetë.

Uniteti islam është një prej shtyllave më të rëndësishme të fesë, së cilës, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë. I nderuari Imam ka vënë në shërbim të realizimit të kësaj çështjeje të madhe një pjesë të rëndësishme të jetës së tij.

Ajo është një fjalë e vetme, një përkushtim i vetëm, një anagazhim i vetëm kundër armiqve të përbashkët.

Uniteti islam është kështjella e fortifikuar për të cilën ka folur vazhdimisht Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë. Uniteti është vëllazëria që duhet të ekzistojë ndërmjet myslimanëve. Është themeli i vëllazërisë mes myslimanëve, të cilin i Dërguari i Allahut e solli në Medine. Ishte vëllazërimi ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve projekti profetik ai që përfaqëson bashkimin dhe vëllazërimin ndërmjet të gjithë myslimanëve. Ky ka qenë orientimi strategjik i Profetit tonë të dashur, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që prej ditës së parë që emigroi në Medine.

Për unitetin islam, për këtë shtyllë të rëndësishme të Islamit ka folur gjerësisht në këtë libër lideri i kësaj kauze të madhe, Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*.

Le të shpresojmë që ta trajtojmë në mënyrë sa më të plotë këtë çështje në kapitujt e ndryshëm të këtij libri. E lusim Allahun e Madhëruar që të na ndihmojë dhe të na furnizojë më mundësitë e duhura që ta ndihmojmë sa të mundemi fenë e Tij. Nuk ka dyshim se Ai është Ndihmuesi më i Mirë. Ai u përgjigjet lutjeve.

Shoqata Islame "El Mearef"

KAPITULLI I PARË

Rëndësia e Unitetit dhe rrënjët e tij

Uniteti islam është një nga çështjet kryesore që është trajtuar gjerësisht kohët e fundit. Diskutimi rreth tij ka pushtuar mediymet e myslimanëve, ligjëratat, fjalimet dhe mediat e tyre. Të gjitha këto përpjekje meritojnë respekt dhe falënderim, sepse synojnë rrënjosjen e këtij uniteti në mendjet dhe zemrave e besimtarëve.

Për të trajtuar thelbësisht këtë çështje duhet të gjejmë rrënjët e saj tek urdhëresat dhe dispozitat islame. Uniteti i myslimanëve nuk ka qenë kurrë mendim i një mendimtari të vetëm, i cili mendon se kjo ide u shërben myslimanëve dhe çështjes së tyre të madhe. E vërteta është se origjina e unitetit si formë islame e të menduarit është te zemra e Islamit, te thelbi i tij. Kjo i jep unitetit disa karakteristika, prej të cilave, më të rëndësishme janë:

1. Uniteti në vetvete përfaqëson një mendim origjinal të pavarurur që ka vetëekzistuar. Ai nuk është rezultat i hulumtimit shkencor dhe i mendjes njerëzore.

2. Uniteti islam është përfaqësues i një dimensioni të qartë dhe bindës për njerëzit, sepse ai përfaqëson një çështje që është në interesin e të gjithë myslimanëve. Është një çështje që u përket të gjithë atyre që dëshmojnë një përkatësi të qartë islame.

3. Uniteti islam është një çështje që mbështetet nga të gjithë elementët që i sigurojnë atij vazhdimësi, në ndryshim nga kultura të ndryshme që nuk kanë bazë të qëndrueshme. Nisur nga ky fakt, mund të themi dhe mund të besojmë se uniteti islam është garanci që siguron zgjidhjen e të gjithë çështjeve të myslimanëve në të gjitha periudhat e historisë.

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, **promovues dhe lider i unitetit**

Në kohën kur bota islame po kalonte ditët e saj më të vështira dhe gjendej në "shtratin e vdekjes" lindi një rreze shprese në horizont. Populli i vetmuar i Iranit, me në krye dijetarin dhe asketin, luftëtarin e madh, Imam Khomeinin, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, organizoi një revolucion të madh dhe të bekuar që u quajt "Revolucioni

islamik i Iranit". Ky Revolucion ka qenë tronditja më e madhe për shërbimet sekrete amerikane dhe ato izraelite. Irani ka qenë një tokë e grabitur dhe e humbur. Atë e kishin shqyer Fuqitë e Mëdha, herë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe herë tërthorazi, përmes bashkëpunëtorëve të brendshëm. Shërbëtorët më të devotshëm në dëm të çështjes kombëtare kanë qenë qeveritarët dhe pushtetarët e shitur. Ata kanë tradhëtuar interesat e popujve të tyre për të mbrojtur interesat dhe pushtetin e tyre. Këta u janë nënshtruar pa asnjë kusht urdhërave të imperializmit botëror, i cili synon të fusë në dorë të mirat materiale të popujve të botës.

Organizimi me sukses i këtij revolucioni madhështor shkatëroi një pjesë të madhe të planeve të armiqve. Plani më i madh i tyre ishte përçarja e myslimanëve, ndarja e tyre në grupe e fraksione të ndryshme. Për këtë qëllim u investuan shumë energji dhe vlera materiale nga imperializmi botëror. Përçarja e myslimanëve në grupe dhe fraksioneve të ndryshme kishte për qëllim t'i hedhë myslimanët kundër njëri-tjetrit si e vetmja strategji që garanton realizimin me sukses të planeve të tyre për t'i nënshtruar myslimanët. Të njëjtën strategji e kanë përdorur edhe për të nënshtruar popujt e tjerë të botës. Teoria e mirënjohur "përçaj e sundo" gjatë gjithë historisë ka qenë instrumenti më i përshtatshëm që kanë përdorë të gjitha fuqitë, sipas interesave konjukturalë.

Një popull të hutuar dhe të përçarë është shumë më e lehtë ta përçash. Pasi t'i kenë zhytur në situata të tilla çorientuese dhe pasi të kenë arritur përçarjen e myslimanëve, armiqve nuk u mbetet gjë tjetër, përveçse të presin me lumturi të madhe përfitimin e fryteve.

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka qenë i vetëdijshëm për rrezikun që u kanosej myslimanëve. Pjesa më e madhe e ligjëratave, e fjalimeve dhe e referateve të tij është e mbushur me këshilla, ftesa dhe thirrje drejtuar myslimanëve për unitet. Ai nuk i ka kursyer energjitë e tij për t'u shpjeguar myslimanëve rrezikun që u kanoset, në rast se përçahen dhe kanë kundërshti ndërmjet tyre. Kjo është çështja rreth të cilës do të përpiqemi të hedhim dritë sa të mundemi. Uniteti islam nuk është trajtuar vetëm në rrafshin teorik prej Imamit të nderuar. Ai ka qenë promovuesi dhe mbështetësi kryesor i ushtrimit në praktikë të unitetit islam duke e lënë atë trashëgimi edhe për brezat e ardhshëm. Kjo çështje do të jetë më e prekshme në vijim në këtë libër.

Rrënjët kur'anore të Unitetit Islam

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë thotë:

﴿وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعاً وَلا تَفَرَّقُوا وَاذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَاناً وَكُنْتُمْ عَلَى شَفَا حُفْرَةٍ مِنَ النَّارِ فَأَنْقَذَكُمْ مِنْهَا كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ﴾

"Të gjithë mbahuni të lidhur fort me Allahun, përmes Kur'anit dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntitë e Allahut për ju. Kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Kur ju ishit buzë greminës së zjarrit, Ai ju shpëtoi. Kështu jua shpjegon Allahu i Madhëruar Shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë."[1]

Udhëzimet e përmendura në ajetin kur'anor janë të prera dhe flasin qartë për domosdoshmërinë e unitetit ndërmjet myslimanëve. Ajetet u drejtohen myslimanëve me ftesën për t'u kapur fort pas litarit të Allahut, pas Kur'anit. Kjo lidhje me Allahun përmes Kur'anit dhe ky lloj solidariteti synon pagabueshmërinë dhe mbrojtjen. Kjo do të thotë njëherësh se heqja dorë prej këtij solidariteti nënkupton automatikisht humbjen dhe shkatërrimin që

[1] Surja Ali Imran, ajeti 103.

vijnë si rezultat i natyrshëm dhe i pashmangshëm i përçarjeve dhe i konflikteve.

Allahu i Madhëruar na begatoi ne me mirësinë e madhe të Islamit, me fenë tonë. Kjo fe madhështore na përfshin të gjithëve me të gjithë diversitetin, me kundërshtitë, apo mosdakordësitë që mund të kemi për çështje të caktuara. Është kjo fe madhështore dhe gjithëpërfshirëse që e ka mundësinë të na mbështjellë të gjithëve ne, edhe pse kemi qenë të ndarë dhe të përcarë me njëri-tetrin për arsye të identitetve tona të ndryshme fisnore, racore, kombëtare, gjeografike dhe kulturore. Ditën që Allahu i Madhëruar na udhëzoi dhe na bëri pjesë të planeve të Tij, ditën që Allahu i Madhëruar na bëri pjesë të udhëzimit me të cilin erdhi Muhamed Mustafai, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, na ka nxjerrë automatikisht prej skutave të errëta të ndasive dhe kundërshtive false, për tek mëshira, gjerësia, paqja dhe mëshira e Islamit. Kjo është njëra prej mirësive më të mëdha me të cilat na ka begatuar Allahu i Madhërishëm.

Në Kur'anin Famëlartë gjeneden shumë ajete që sqarojnë rëndësinë e madhe të unitetit islam dhe lënien mënjanë të konflikteve, urrjejtjes dhe përçarjes.

Për ta ilustuar këtë po sjellim disa prej atyre ajeteve, në të cilat Allahu i Madhëruar thotë :

﴿وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ وَاصْبِرُوا إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ﴾

"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin dhe do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit."[2]

﴿إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلِحُوا بَيْنَ أَخَوَيْكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

"Vërtet, myslimanët janë vëllezër me njëri-tjetrin, prandaj është detyra juaj që t'i pajtoni ata. Kijeni frikë Allahun, nëse e shpresoni vërtet Mëshirën e Tij."[3]

﴿وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾

"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, për në fenë e pastër islame, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit."[4]

[2] Surja "El Enfal", ajeti 46.
[3] Surja "El Huxhurat", ajeti 10.
[4] Surja "Ali Imran", ajeti 104.

﴿وَلا تَكُونُوا كَالَّذِينَ تَفَرَّقُوا وَاخْتَلَفُوا مِنْ بَعْدِ مَا جَا هُمُ الْبَيِّنَاتُ وَأُولَئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ﴾

"Mos u bëni si ata, të cilët, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh."[5]

﴿إِنَّ الَّذِينَ فَرَّقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيَعاً لَسْتَ مِنْهُمْ فِي شَيْءٍ﴾

"Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Te Allahu është puna e tyre. Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar."[6]

﴿وَإِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاتَّقُونِ﴾

"Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, prandaj frikësohuni prej Meje."[7]

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, bazuar në këto ajate ka hedhur dritë dhe i ka dhënë rëndësi të veçantë unitetit islam. Ai e ka trajtuar unitetin islam si kërkesë shumë të rëndësishme fetare dhe

[5] Surja "Ali Imran", ajeti 105.
[6] Surja "El En'am", ajeti 159.
[7] Surja "El Mu'minun", ajeti 52.

kur'anore. Lidhur me këtë aspekt, citohet që ai të ketë thënë kështu:

"Kur'ani e ka trajtuar si aktin më të rëndësishëm të besëlidhjes marrëdhënien e besimtarëve ndërmjet tyre. Shpresa ime e madhe është që të jemi bashkë dhe të jemi një, të gjithë iranianët, sepse të gjithë myslimanët janë vëllezër, pavarësisht nëse janë shiitë apo sunitë. Kam një dëshirë të madhe që t'i shoh të bashkuar të gjithë anëtarësinë e Kombit, përfshi pakicat e feve të tjera. Më lejoni të shpreh aspiratën dhe dëshirën time të madhe që t'i shoh këto pakica të vëllazëruar më të gjithë pjesën tjetër të anëtarëve të Kombit. Ky unitet dhe kjo vëllazëri duhet të vihet në funksion dhe në ndihmë të stabilitetit të vendit dhe të zhvillimit të tij. Kjo është mënyra më e mirë që na ndihmon të zbatojmë ligjin e Zotit dhe të vemë në jetë dispozitat e Islamit. Kjo është e vetmja mënyrë për të siguruar mirëqënien, paqen dhe zhvillimin për të gjitha shtresat e popullsisë duke përfshirë llojet e ndryshme të pakicave që përfshihen në të. Kam një dëshirë të pamatë që popujt e tjerë myslimanë të mos ndihen të veçuar. Duhet të jemi të bashkuar, sepse Kur'ani Famëlartë na konsideron vëllezër të njëri-tjetrit. Ai e ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë të prerë kornizën e aktit të vëllazërisë së nënshkruar ndërmjet besimtarëve që prej ditës kur pranojnë Islamin si fe. Kështu, pra, një mysliman që gjendet në një cep të botës dhe një besimtar mysliman që

gjendet në cepin tjetër të saj, janë vëllezër me njëri-tjetrin, edhe pse ata janë shumë larg njëri-tjetrit. Për asnjë arsye nuk duhet të ndahen me njëri-tjetri. Ata duhet të mbeten vëllezër, sido që të vijnë rrethanat e jetës. Ky është një udhëzim i qartë dhe i prerë i Islamit. Myslimanët, kudo qofshin nëpër botë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kuptojnë se interesi i tyre i përbashkët është ai i Islamit dhe se interesi i Islamit është në interesin e gjithë njerëzimit. Duhet që popujt myslimanë të besojnë se interesi i popullit tjetër është edhe interesi i popullit të tyre. Është e domosdoshme që myslimanët të jenë vëllezër me njëri-tjetrin dhe të konsiderojnë armiqtë që ushtrojnë padrejtësi ndaj njërit prej tyre si armikun e të gjithëve. Çdo sulm që ushtrohet ndaj një shteti mysliman duhet të konsiderohet si sulm ndaj të gjithë myslimanëve. Jam shpresëmadh dhe besimplotë se kjo Qeveri islame, e cila i konsideron të gjithë njerëzit dhe të gjithë besimtarët vëllezër të njeri-tjetrit, të bëjë më të mirën e saj. Shpreh dëshirën time të madhe që të gjitha vendet islame të zotërojnë fatet e tyre, të triumfojnë ndaj planeve djallëzore të Fuqive të Mëdha si dhe të munden që të venë në jetë të gjitha dispozitat islame."

Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka paralajmëruar vazhdimisht për rrezikun e madh të përçarjes dhe të konflikteve ndërmjet myslimanëve. Lidhur me këtë aspekt ai thotë:

"Është detyrë madhore e të gjithë myslimanëve sot që të bashkohen me njëri-tjetrin. Është detyrë e tyre që të mos konfiktohen ndërmjet njëri-tjetrit për shkak të dispozitave të fesë, sepse Islami e ka ndaluar rreptësisht konfliktin dhe përçarjen. Eshtë e ndaluar rreptësisht përçarja dhe konflikti ndërmjet myslimanëve, cilado qoftë arsyeja. Kjo theksohet në tekstet e Kur'anit Famëlartë dhe në hadithe të ndryshme. Të gjithë duhet të binden se konfliktet dhe përçarja ndërmjet myslimanëve është dobësim, dëshpërim dhe humbje për të gjithë ata, qoftë ky konflikt në nivel individual, qoftë në nivel shtetëror. Këto janë udhëzimet dhe urdhërat e prera të Allahut, të cilat nuk duhen nënvlerësuar në asnjë mënyrë. Të gjithë ata që pretendojnë Islamin, që përpiqen të përçajnë myslimanët dhe të mbjellin ndërmjet tyre konflikte, nuk janë pasues të Islamit të vërtetë, nuk janë të lidhur shpirtërisht me Qabenë. Islami nuk ka zënë vend akoma në zemrat e tyre. Besimtarë dhe myslimanë të vërtetë janë ata që u dorëzohen plotësisht urdhëresave të Islamit dhe dispozitave të tij. Besimtarë të vërtetë janë ata që i nënshtrohen frymës së Kur'anit, i cili i konsideron të gjithë besimtarët vëllezër të njëri-tjetrit. Është detyrë e të gjithë myslimanëve që të venë në jetë të gjitha derivatet që rrjedhin prej termit "vëllazëri". Nuk ka dyshim se vëllazëri e plotë dhe e sinqertë do të thotë që të gjithë besimtarët të ndiejnë dhimbje për dhimbjet e njëri-tjetrit dhe të gëzohen për gëzimet e njëri-tjetrit.

Uniteti Islam në traditën e nderuar profetike

Janë të shumta transmetimet dhe hadithet që paralajmërojën rrezikun e përçarjes dhe të konfliktit ndërmjet myslimanëve. Ky paralajmërim është bërë duke vënë në pah arsyet dhe shkaqet që provokojnë konflikte të tilla. Po sjellim disa prej këtyre faktorëve që provokojnë përçarje dhe konflikt ndërmjet myslimanëve.

Heretizimi, (Et-Tekfiir)

Heretizmi, (tekfiri), përjashtimi i njerëzve prej fesë dhe gjykimi i tyre si mohues të saj është njëri prej fenomeneve më të rrezikshme, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtjë në përçarjen e myslimanëve dhe në nxitjen e konflikteve ndërmjet tyre. Ai është pengesa, muri, diga, ndarësi më i madh, i cili pengon dialogun dhe komunukimin normal ndërmjet njerëzve. Pengesa e realizimit të dialogut do të thotë pamundësi dhe paaftësi për të mbërritur tek e vërteta, cilado qoftë ajo. Kjo do të thotë që në vend që të krijohet klima e përshtatshme për të realizuar dialogun dhe gjetjen e së vërtetës, ta gjykosh kundërshtarin tënd me nxjerrje prej feje. Nxjerrja e tij prej feje është automatikisht ndërprerje e mundësisë për komunikim dhe dialog njerëzor normal. Në një transmetim të Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi*

të dhe mbi familjen e tij!), trajtohet pikërisht ky fenomen i rrezikshëm duke thënë kështu:

"Ai mysliman që i thotë vëllait të tij mysliman që ti je mohues, (kafir) është sikur ta ketë vrarë atë."[8]

Bilal Habeshiu transmeton se Profeti i nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ka thënë :

"O Bilal! Dil dhe njoftoi myslimanët se të gjithë ata që dëshmojnë se nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut të Madhëruar dhe se Muhamedi, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është i Dërguari i Allahut, një vit përpara se të ndahet nga kjo jetë, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. I njëjti shpërblim është edhe për ata që e thonë një muaj, një javë, një ditë dhe një orë më parë."[9]

Në një tjetër hadith të Profetit, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet :

"Njerëzit në Ditën e Gjykimit do të jenë pranë atyre që i duan dhe të gjithë ata që dëshmonë se nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut të Madhëruar dhe se Muhamedi, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe*

[8] "Biharul Enuar", El Allameh El Mexhilisij, vëll 69, fq 209.
[9] "Kenzul Umal", El Mutteki El Hindi, vëll 1, fq 64.

mbi familjen e tij!), është i Dërguari i Allahut, do të hyjnë në Xhenet."[10]

Vëllavrasja

Vëllavrasja dhe luftimi ndërmjet myslimanëve është qëllimi më i madh i të gjithë atyre që synojnë të përçajnë myslimanët. Ky është rreziku i madh për të cilin kanë paralajmëruar transmetimet e ndryshme. Transmetohet prej Hudhejfe ibnul Jeman, që ai të ketë thënë se Profeti i Zotit, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të ketë thënë:

"Kam frikë dhe i trembem shumë një fenomeni shumë të rrezikshëm që do të përhapet ndër myslimanët. Do të ketë prej atyre myslimanëve që do t'u ndriçojnë fytyrat nga leximi i Kur'anit. Do të ketë prej atyre besimtarëve që do ta mbajnë të veshur rrobën e Islamit gjatë gjithë jetës së tyre, por në një moment disa prej tyre do të shpërfytyrohen dhe do ta zhveshin atë robë, do të ngrejnë shpatën ndaj fqinjëve të tyre dhe do t'i akuzojnë ata për mohim e politeizëm. Hudhejfja tha: Thashe: 'O i Dërguari i Allahut! Cili prej tyre është është viktima, i akuzuari, apo akuzuesi?!' I Dërguari i Allahut tha: 'Akuzuesi'".

[10] "Es Siratul Mustekiim", Ali Bin Junus El Amilij, vëll 1, fq 199.

Në një tjetër transmetim prej Profetit të Islamit, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, trasnmetohet që në njërën prej ligjeratave të mbajtura në Haxh, ai të ketë thënë:

"O ju besimdrejtë! Duhet ta dini se gjaku, nderi dhe pasuritë tuaja janë të shenjta dhe të paprekshme prej askujt. Ato kanë shenjtëri të njëjtë me shenjtërinë e këtij muaji, me shenjtërinë e kësaj dite dhe me shenjtërinë e këtij vendi. Do të vijë një ditë kur do të jepni llogari përpara Krijuesit tuaj dhe Ai do t'ju pyesë imtësisht për punët tuaja. Ju paralajmëroj: kur unë të mos jem më në këtë jetë, të hiqni dorë prej vradjes dhe luftës me njëri-tjetrin. Dëshmoni përpara Zotit se unë e kam përcjellë mesazhin dhe të pranishmit të njoftojnë ata që nuk kanë qenë."[11]

Ky ka qenë mendimi, sjellja dhe orientimi i Imamit tonë të nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*. Njëlloj si i Dërguari i Allahut, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai ka paralajmëruar vazhdimisht rreth rrezikut të luftimit, të konfliktit dhe të përçarjes ndërmjet myslimanëve. Ai i ka ftuar myslimanët në vazhdimësi që të bëjnë kujdes dhe të eliminojnë çdo lloj përcarje ndërmjet anëtarëve të një ymeti të vetëm. Vështroni sa elokuente është kjo shprehje e Imamit të nderuar:

[11] "E'ajanush Shiah", Es Sejjid Muhsinul Emin, vëll 1, fq 290.

"Çdo fjalë dhe çdo shprehje që mund të bëhet shkak për përçarjen e myslimanëve është e dalë prej gjuhës së një shejtani."[12]

Në një tjetër rast, transmetohet prej Imamit që të jetë shprehur dhe të ketë thënë kështu:

"Nuk ka dyshim se përçarja e myslimanëve është prej punëve të shejtanit, ndërsa bashkimi dhe unitetit i tyre është prej punëve të Rrahmanit, Mëshiruesit"

Të shtrenjtët e mi!

"Ju ftoj ta evitoni konfliktin dhe përçarjen ndërmjet jush, sepse ajo është prej nxitjeve të Iblisit të mallkuar. Edhe nëse ndodh që të kemi kundërshti apo mospajtim në mes tonë, është e nevojshme që të ulemi dhe të dialogojmë në mënyrë konstruktive dhe të qetë. Kjo është mënyra më e përshtatshme për të zgjidhur konfliktet mes nesh. Në rast të kundërt, nëse konfliktohemi më njëri-tjetrin, duke u sharë dhe duke u akuzuar për heretizëm, njerëzit do të hyjnë në trishtim të thellë dhe kanë për të na braktisur pa më të voglin dyshim."[13]

[12] "El Kelimatul Kisar", vëll i parë.
[13] "El Kelimatul Kisar", vëll i parë.

Rreziqet e përçarjes

Nëse do të bëjmë një analizë të hollësishme rreth rreziqeve që i kanosen ymetit prej përçarjes dhe konfliktit, do mbërijmë në përfundimin se të gjithë anëtarët e ymetit mbajnë përgjegjësi për unitetin e myslimanëve dhe për evitimin e përçarjes ndërmjet tyre. Problemi më i madh qëndron tek papërgjegjshmëria e disa njerëzve që e kanë të vështirë ta kuptojnë se kundërshtia në mendime nuk zgjidhet me konflikt dhe me shkatërrim të njëri-tjetrit. Është tërësisht e patolerushme dhe e papranueshme që kundërshtia në mendime të prodhojë konflikt të përmasave të atilla sa t'i shtyjnë myslimanët të nxjerrin njëri-tjetrin nga feja dhe të akuzohen për heretizëm. Në fakt, po t'u bësh një analizë të qetë e të hollësishme këtyre deduksioneve, do të vërejmë se ky është problem i vogël në krahasim më disa situata që janë akoma më të rrezikshme dhe më të komplikuara. Problemi më i madh nuk qëndron tek njerëzit e thjeshtë, por te zotëruesit e posteve të rëndësishme drejtuese në vendet islame. Ata, edhe pse janë të vetëdijshëm për rrezikun e madh që u kanoset myslimanëve, edhe pse janë në dijeni të planeve dhe të kurtheve që ngrejnë armiqtë e Islamit natën dhe ditën, nuk bëjnë asnjë përpjekje serioze për ta shmangur këtë rrezik. Ata nuk e kuptojnë se ky është një rrezik që i kanoset edhe karrigeve të tyre. Përfundimisht, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, i përmbledh dhe i

paraqet shkurtimisht dy problematikat kryesore që lidhen me këtë aspekt. Ai thotë kështu:

"Të gjithë jemi të vetëdijshëm, qoftë në nivel individual qoftë në nivel drejtuesish të vendeve myslimane, se gjithçka që po ndodh në vendet myslimane e ka burimin tek dy problematika kryesore.

Ato janë :

Problematika e parë:

"Problemi i parë qëndron te konfliktet që shtetet nuk i kanë zgjidhur mes tyre. Këto konflikte janë burimi kryesor i fatkeqsive të myslimanëve. Ne e kemi ngritur këtë problem dhe e kemi trajtuar prej njëzet vitesh. Kemi shkruar, kemi folur, kemi ftuar krerët e vendeve islame për t'u bashkuar me njëri-tjetrin, por fatkeqësisht nuk ka patur asnjë reagim serioz deri tani."

Problematika e dytë:

"Një problem shumë i madh është konflikti i krerëve të shteteve islame me popujt e tyre. Shumë prej këtyre liderëve i kanë parë si rrezik popujt e tyre dhe i kanë trajtuar të bindur se nuk e kanë mbështetjen e tyre. Për arsye të këtij konflikti të madh që egziston ndërmjet qeverive dhe popujve, ndodh shpesh që popujt mos t'u vijnë në ndihmë qeverive të tyre për zgjidhjen e

problemeve me të cilat përballen ato. Janë disa probleme thelbësorë, të cilat nuk mund të zgjidhen pa ndihmën dhe mbështetjen e popullit. Në këto raste (kur ka konflikt dhe mosbesim ndërmjet Qeverisë dhe popullit) popujt qëndrojnë indiferentë në rastin më të mirë, por ndodh që ta thellojnë krizën më tej, në raste të tjera."[14]

Në rast se myslimanët, do të arrijnë t'i tejkalojnë këto dy problematika të mëdha dhe të rrisin nivelin e besueshmërisë ndërmjet qeverive dhe popujve, nuk ka dyshim se triumfi dhe fitorja do të jenë në anën e tyre. Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Nëse popujt myslimanë dhe qeveritë e vendeve islame do të ndërtojnë urat e komunikimit dhe do të jenë më bashkëpunues ndërmjet tyre, nëse do të venë në dispozicion të vendeve të tyre të gjitha energjitë njerëzore e jetike, nëse do të bashkërendojnë energjithë e tyre, nëse do të evitojnë frikën prej oligarkëve, padronë të kështjellave dhe të pasurive të mëdha, nëse do të shmangin propagandën përçarëse të gatuar prej mediave të mashtrimit, nëse do të bëhen bashkë dhe të ngrenë zërin kundër Fuqive të Mëdha duke u mbështetur tek Allahu i Madhëruar dhe tek Fuqia e Tij e madhe dhe e

[14] Shkëputur prej fjalimit të Imamit të nderuar të mbajtur në një takim ku flitej për unitetin e myslimanëve dhe mbështetjen e Palestinës.

pashtershme, nëse do të kërcënojnë seriozisht këto fuqi me mbylljen e kufijve dhe me bllokimin e naftës, sigurisht që armiqtë e tyre do të nënshtrohen, do të heqin dorë prej planeve përçarëse ndaj myslimanëve."

Në fund të kësaj trajtese, pasi kemi shpalosur problematikat kryesore me të cilat përballen vendet islame dhe rreziqet që u kanosen atyre, e shohim me vlerë dhe si shumë të rëndësishme të shpalosim edhe elementët e fuqisë së ymetit. Kjo është e rëndësishme, sepses sjell në vëmendjen e lexuesit fuqinë e ymetit, sjell këto elementë të fuqisë për të cilat duhet të përkujdesemi të gjithë, si e vetmja rrugë dhe mundësi për të ruajtur autoritetin e ymetit dhe për ta mbrojtur atë reziqeve të ndryshme.

KAPITULLI I DYTË

Format e Unitetit dhe shtyllat e tij

Hyrje

Të gjitha shkollat e juridiksionit islam janë dakordësuar për një pjesë të madhe të dispozitave islame. Gjërat që i bashkojnë janë më të shumta se gjërat që i ndajnë. Në rast se myslimanët do të gjenin fuqi për të tejkaluar kundershtitë ndërmjet tyre dhe të bashkohen në çështjet e përbashkëta, duke i lënë menjëanë kundërshtitë dhe gjërat që i ndajnë, do të ishin populli dhe aleanca më e fortë në botë. Është kjo arsyeja që Fuqitë e Mëdha dhe armiqtë e myslimanëve kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë intensivisht për t'i ngacmuar dhe për t'i gjallëruar këto kundërshti sa më shumë, sepse kjo është mënyra më e mirë dhe strategjia më efikase për t'i mbajtuar ata të përçarë. Për t'i realizuar këto qëllime ata kanë përdorur të

gjitha mundësitë që kanë në dispozicion, duke filluar me mediat, gazetarët, penat e shitura, apo të lëshuarat me qera. E çuditshme është puna e myslimanëve. Si është e mundur që lëmë pas të gjitha këto pika të përbashkëta dhe baza të gjera mbi të cilat mund të ndërtojmë platformat dhe strategjitë tona të unitetit dhe merremi me detaje fare të parëndësishme që na armiqësojnë dhe na përçajnë?! Kjo është arsyeja kryesore, përse myslimanët, në vend që të jemi të unifikuar, të bashkuar dhe solidarë me njëri-tjetrin, ashtu siç ka urdhëruar Allahu i Madhëruar, jemi të ndarë, të armiqësuar dhe të përçarë.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Përçarja e myslimanëve dhe nxitja e armiqësive ndërmjet tyre, është vepër e atyre që e shpallin Islamin, por në thelbin e tyre nuk janë myslimanë. E fshehin besimin, por nuk janë në thelb besimtarë. Këta njerëz, janë prej atyre që u kthejnë kurrizin mësimeve, direktivave dhe dispozitave të qarta të përmendura në Kur'an, ku bëhet ftesë qartësisht dhe në mënyrë të përsëritur për unitet e bashkim. Të gjithë ata që investohen në këtë lloj përçarjeje të besimtarëve janë ata që e kanë pranuar Islamin për qëllime sipërfaqësore, jo gjithmonë të sinqerta. Kjo është arsyeja përse ata e refuzojnë Kur'anin dhe kuptimet e mëdha që përcjell ai. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

﴿إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ﴾ **'Nuk ka dyshim se besimtarët janë vëllëzër për njëri-tjetrin.'**.[15] Në këtë ajet tregohet qartë se besimtarët duhet të plotësojnë të gjithë kriteret e vëllazërisë në raport me njeri-tjetrin, të bashkëpunojnë sipas urdhërit të dretpërdrejtë të Allahut të Madhëruar." Imami i nderuar vijon: "Është kusht elementar dhe kriter thelbësor i vëllazërisë që besimtarët të ndiejnë dhimbje për dhimbjet e vëllezërve të tyre dhe të kënaqen për lumturinë e tyre."[16]

Për mediat e ndryshme që përpiqen të nxisin konflikt ndëmjet myslimanëve Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë :

"Nuk ka dyshim se qëllimi i tyre kryesor është të përhapin përçarje, kundërshti, armiqësi dhe urretje ndërmjet besimtarëve. E vërteta është se të gjithë besimtarët janë vëllezër dhe nuk duhet të bien në kurthin e disa elementeve negativë që duan përçarje dhe konflikte ndërmjet besimtarëve. E gjithë kjo çështje është e lidhur me marrëdhënien ndërmjet myslimanëve synitë dhe atyre shiitë. Përpjekja e madhe e mediave është e lidhur me provokimin e luftës dhe të konflikteve sektare ndërmjet myslimanëve synitë dhe shiitë. Në fakt, përpjekjet e tyre

[15] Surja "El Huxhurat", ajeti 10.

[16] Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej Shkëlqesisë së tij lidhur me unitetin islam dhe mbrojtjen e Palestinës.

nuk ndalen vetëm këtu, por shtrihen edhe më tej. Ato synojnë të provokojnë konflikte, urrejtje, armiqësi e përçarje ndërmjet vetë shiitëve dhe, herë të tjera, edhe ndërmjet vëllezërve tanë myslimanë synitë.

Të gjithë fraksionet dhe shkollat e juridiksionit islam gjenden përballë një trysnie të jashtëzakonshme. Ato përballen me llojet dhe format e ndryshme të kurtheve djallëzore, me qëllim shkuljen e Islamit nga rrënjët dhe zhdukjen përfundimtare të tij.

Këta popuj janë të vetëdijshëm se feja islame është armiku i tyre më i madh. Si të tillë e kanë identifikuar dhe si të tillë e trajtojnë, herë në mënyrë të hapur herë në mënyra më konspirative. Popujt myslimanë janë të vetmit që mund t'i kërcënojnë seriozisht ata.

Lind si detyrë imediate e të gjithë myslimanëve të botës që të bashkohen me njëri-tjetrin dhe të unifikojnë fuqitë dhe energjitë e tyre. Ky qëllim madhor nuk mund të realizohet nga grupe të vetëshpallura si të para, si liderë të fushës ."[17]

Le të hedhim dritë rreth disa pikave të rëndësishme mbi të cilat myslimanët mund të ndërtojnë platforma serioze të bashkëpunimit dhe të forcojnë unitetin ndërmjet tyre. Kjo është e vetmja rrugë e cila do t'u sigurojë arritjen

[17] Burimi i mëparshëm.

e niveleve të larta, në të cilat don t'i shohë Allahu i Madhëruar.

Haxhi, (pelegrinazhi) **dhe Uniteti i myslimanëve**

Haxhi është njëri prej praktikave dhe ngjarjeve më madhështore nëpërmjet të cilit shpaloset dimensioni unifikues dhe bashkues i myslimanëve. Haxhi është shfaqja më madhështotre nëpërmjet të cilës shpalosen qartësisht fuqitë dhe energjitë e vërteta të myslimanëve. Ai është një laborator i vërtetë në të cilin vihen në provë fuqitë e tyre morale dhe materiale.

E vërteta është se Haxhi ngjason me Kur'anin Famëlartë. Prej tij përfitojnë të gjithë. Në rast se dijetarët e Islamit, adhuruesit e mëdhenj të Allahut të Madhëruar do të provonin ta zbulonin për njerëzimin këtë oqean të madh, nëse do të provojnë të zhyten thellësive të tij për të mbledhur perla e xhevahire që fshihen thellësive të tij, nuk ka dyshim se do të zbulojnë atje, dispozita të vyera dhe dimensione të mahnitshme të vëllazërisë dhe të unitetit ndërmjet myslimanëve. Do të zbulojnë atje politika sociale nga më të zhvilluarat dhe modernet. Ata do të zbulojnë tek ato thellësi mendimin e mprehtë, udhëzimin, udhërrëfimin, qartësinë, kthjelltësinë, urtësinë dhe pavarësinë. Do të gjejnë në brendësi të atyre thellësive

freskinë më të cilën do të shuajnë njëherë e përgjithmonë etjen e mendjeve të tyre dhe të urtësisë."[18]

Haxhi, (peligrinazhi), është përfaqësues i dimensioneve të larmishme unifikuese dhe bashkuese ndëmjet myslimanëve. Ai është konferenca më e madhe e përvitshme e myslimanëve nga e gjithë bota. Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë se nuk gjendet mbi rruzullin tokësor një shtet që mundet të mbledhë kaq shumë njerëz, prej vendeve të ndryshme të globit, në një vend të vetëm, në një shtëpi të vetme, me një venddrejtim të vetëm, prej një feje të vetme, adhurues të një Zoti të Vetëm, që ushtrojnë një praktikë të vetme, adhurimin e Profetit të tyre, *(Pqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)*. Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Gjatë kohës kur myslimanët e mbledhur prej vendeve të ndryshme të botës, vijnë në Shtëpinë e Allahut, në Qabenë e nderuar, për të kryer një ritual kaq të shenjtë të Islamit dhe për të marrë pjesë në këtë kongres të madh të myslimanëve të mbledhur nga e gjithë bota, në ditë të shenjta dhe në një vend të shenjtë, lind si detyrë madhore e tyre që, përveç dimensionit adhurimor, të përfitojnë edhe prej dimensionit politik dhe social të Haxhit. Është detyrë e

[18] Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej Imam Khomeinit (Zoti qoftë i kënaqur me të) ku flitet rreth Haxhit dhe dimensioneve të ndryshme të tij.

të gjithë adhuruesve të Allahut që të mos ndalen vetëm tek dimensioni sipërfaqësor i këtij rituali. Të gjithë janë të vetëdijshëm se nuk ka mbi sipërfaqen e tokës asnjë personalitet dhe asnjë shtet, sado të fuqishëm qofshin, që të mbledhin një konferencë kaq të madhe sa kjo. Kjo është e pamundur. Janë urdhërat, dispozitat dhe kërkesa e Allahut të Madhëruar të vetmet që mund të ndikojnë në realizimin me sukses dhe të përvitshëm të një konference si kjo.

Është fatkeqësi e madhe që në të gjithë historinë e tyre të gjatë myslimanët nuk kanë mundur të përfitojnë prej këtij okazioni të madh të Zotit, prej kësaj mundësie të jashtëzakonshme, prej kësaj konference madhështore të përvitshme që mund ta ndihmojë më shumë Islamin dhe myslimanët."[19]

Duke qenë se Haxhi është përfaqësues i këtyre dimensioneve madhështore dhe një mundësi e jashtëzakonshme për unifikimin e myslimanëve, lind si detyrë e të gjithë myslimanëve që të përpiqen me të gjithë mundësitë e tyre që të përfitojnë nga kjo ngjarje e madhe dhe të realizojnë unifikimin e tyre. Është detyrë e të gjithë myslimanëve që të bëjnë të mundurën e të përfitojnë sa më shumë prej këtij okazioni që u paraqitet atyre njëherë në vit. Kjo është mundësia më e madhe dhe më e rëndësishme

[19] Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ku flitet rreth Haxhit dhe dimensioneve të ndryshme të tij.

që myslimanët kanë për t'u mbledhur të gjithë bashkë, për të përcaktuar armiqtë e tyre të mëdhenj, për të renditur me kujdes prioritetet e secilit dhe për të identifikuar rreziqet e mëdha me të cilat përballen. Kjo është e vetmja mundësi që u jepet myslimanëve njëherë në vit për t'i bërë bashkë energjitë e tyre, si e vetmja mënyrë për t'u përballur me armiqtë e tyre të përbashkët.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Prej synimeve dhe qëllimeve kryesore të kësaj konference, të kësaj mbledhjeje, të këtij kongresi të madh është unifikimi i qëndrimeve të popujve myslimanë në mbarë botën si dhe eliminimi i të gjitha kundërshtive dhe barrierave të komunikimit ndërmjet shtresave të ndryshme të tyre. Është detyrë madhore e ligjëruesve dhe e shkrimtarëve myslimanë që të krijojnë infrastrukturën intelektuale dhe ideologjike për krijimin e një fronti të përbashkët në shërbim të të shtypurve të myslimanëve. Një front i tillë i unifikuar dhe i udhëhequr nga dëshmia "La Ilahe Ilall Llah - Muhamedun Resulull'llah - Nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Madhëruar dhe se Muhamedi, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i Dërguari i Allahut, mund të nënshtrojë dhe të mposhtë të gjithë armiqtë e myslimanëve. Ky është i vetmi front dhe e vetmja mundësi, për t'u çliruar prej fuqive të errëta të

djallit dhe prej planeve grabitqare të pushtuesve dhe Fuqive të Mëdha. E vetmja mënyrë dhe e vetmja formulë për zgjidhjen e problemeve të myslimanëve dhe të halleve të tyre është nënshkrimi i aktit të vëllazërisë islame ndërmjet besimtarëve dhe praktikimi i kësaj vëllazërie në realitet."[20]

Të gjithë besimtarët myslimanë në mbarë botën duhet të jenë të vetëdijshëm për dimensionin politik të Haxhit. Janë të shumta shkrimet, librat dhe punimet shkencore të dijetarëve të ndryshëm që theksojnë dimensionin politik, përveç atij adhurimor të Haxhit, të kësaj konference të madhe të përvitshme të Allahut.

Lidhur me këtë, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Gjenden dimensione të ndrysme politike te të gjitha grupimet e myslimanëve dhe llojet e ndryshme të grumbullimeve të tyre, siç është e xhumaja, apo namazi me xhemat dhe vecanërisht bashkimi i madh dhe i çmuar për kryerjen e ritualit të Haxhit. Një dimension tjetër është shqyrtimi i problematikave të ndryshme të myslimanëve, qofshin këto problematika të çështjeve të rëndësishme të adhurimeve të tyre, por edhe me ato të lidhurat me

[20] Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ku flitet rreth Haxhit dhe dimensioneve të ndryshme të tij.

problematikat e tyre politike. Të gjitha këto problematika mund të shqyrtohen me kujdes dhe mund t'u gjenden zgjidhjet përkatëse, prej dijetarëve të ndryshëm, prej besimtarëve intelektualë të devotshëm që shkojnë për të vizituar Shtëpinë e Shenjtë të Allahut të Madhëruar. Pasi t'i kenë studiuar dhe trajtuar me kujdes të gjitha ato problematika, të gjithë kthehen tek popujt e tyre për t'ua përcjellë ato përfundime atyre."[21]

Armiku i përbashkët i myslimanëve dhe i të shtypurve

Myslimanët në mbarë botën duhet të jenë të vetëdijshëm se unifikimi armiqve të tyre është një arsye madhore dhe e mjaftueshme që ata të projektojnë unitetin ndërmjet tyre dhe të lenë mënjanë llojet e ndryshme dhe të parëndësishme të konflikteve dhe të kundërshtive.

Me të gjitha konfliktet dhe kundërshtitë që kanë në mes tyre, armiqtë e Islamit janë të unifikuar në strategjitë e tyre kundër myslimanëve pa dallim sekti, shkolle juridike dhe grupacioni. Unifikimi i qëllimeve dhe i strategjive të tyre e gjen ymetin Islam të dobët, të ndarë, të përçarë dhe

[21] Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* ku flitet rreth Haxhit dhe dimensioneve të ndryshme të tij.

të shkatërruar në mijëra grupe e nëngrupe, në mijëra degë e nëndegë, në mijëra parti e fraksione, duke i goditur ata në mënyrën më të lehtë të mundshme. Të gjithë jemi të vetëdijshëm sot se si Fuqitë e Mëdha dhe grabitqare u shpallin luftë njëri pas tjetrit shteteve myslimane që t'i përcajnë dhe t'i dobësojnë, si mënyra më efektive për t'i shkatërruar. Nëse myslimanët në mbarë botën bashkohen me njëri-tjetrin dhe ndërtojnë një barrikadë të fuqishme përballë planeve të armiqve të tyre, ata nuk do të mund që t'i realizojnë planet e tyre të ulëta dhe zemrat e tyre do të mbërthehen prej frikës. Lidhur me këtë aspekt Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

﴿إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الَّذِينَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِهِ صَفّاً كَأَنَّهُمْ بُنْيَانٌ مَرْصُوصٌ﴾

"Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide."[22]

Kuptimet e këtij ajeti të nderuar janë bërë pjesë e pandërprerë e shumë prej fjalimeve, ligjeratave dhe thirrjeve të Imam Khomeinit, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, drejtuar botës islame. Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Ndërhyrja e Fuqive të Mëdha ndaj vendeve islame, (kemi për shembull agresionin e Bashkimit Sovjetik ndaj

[22] Surja "Es Saff", ajeti 4.

vëllezërve tanë myslimanë në Afganistan) dhe vrasjet e tyre pa mëshirë, thjesht pse ata refuzonin ndërhyrjen, apo përfshirja e Sheteteve të Bashkuara të Amerikës, në çdo fatkeqësi të myslimanëve, sulmet e armikut gjakatar izraelit ndaj popullit palestinez dhe libanez janë tregues të unifikimit të të gjitha strategjive dhe planeve kriminale të armiqve të Islamit. Tregues i tillë është edhe lufta e Izraelit i mbështetur nga ndërkombëtarët për të zbatuar me sukses planet kriminale. Ata kanë për qëllim ta transferojnë kryeqytetin e tyre në Shtëpinë e Shenjtë në Jeruzalem, si dhe të rrisin e të vrasin, shkatërrojnë dhe përzënë palestinezët prej vendbanimeve të tyre. Në këtë kohë të vështirë në të cilën kalon ymeti mysliman është më e nevojshme se kurrë forcimi i unitetit mes myslimanëve. Myslimanët çdo ditë përballen me agjentët dhe me shërbëtorët e fuqive të errëta, imperialiste dhe grabitqare, të cilët bëjnë përpjekjet të mëdha për të përçarë myslimanët dhe për të mbjellë armiqësi ndërmjet tyre. Këta shërbëtorë të Fuqive të Mëdha që dalin prej mesit të myslimanëve, janë ata që kryejnë llojet më makabre të krimeve ndaj popujve të tyre, nëpërmjet zbatimit strikt dhe me rigorozitet të urdhërave të ardhura prej padronëve të tyre të huaj, të cilët i kanë joshur në rrugën e tradhëtisë duke u dhënë postet e pozitat e larta që mbajnë."[23]

[23] Shkëputur prej thirrjes së Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* drejtuar një grupi pelegrinësh datë 2 të muajit Dhil Hixheh, viti 1400 h.

Po t'i kthehemi historisë së Imam Khomenit, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, do të shohim se ai u ka drejtuar shumë thirrje dhe ftesa myslimanëve të mbarë botës për të identifikuar armikun e përbashkët me të cilin janë të gjithë të detyruar të përballen. Ai u ka treguar myslimanëve se bashkimi i tyre dhe unifikimi i energjive të myslimanëve kundër armikut të tyre të përbashkët është e vetmja rrugë, mënyrë dhe strategji e suksesshme, për të ndaluar planet e tyre të liga dhe për t'i paraprirë zbatimit të tyre me ndërtimin e fronteve të përbashkëta. Kjo është e vetmja mënyrë për t'u përballur me qëllimet e tyre të liga dhe me epshet e tyre grabitqare që synojnë pasuritë e ymetit dhe identitetin e tij shumëdimensional.

Po t'i hedhim një vështrim fjalimeve të Imamit të nderuar, do të vërejmë se ai përmbledh tërë problematikën e ditëve të sotme, sikur të ishte midis nesh dhe thotë:

"O ti det i madh myslimanësh! Luftoni dhe shkatërroni armiqtë e njerëzimit. Nëse i mbështeteni Allahut dhe i zbatoni më përpikmëri udhëzimet dhe dispozitat e Tij qiellore, do t'i gjeni ushtritë e Allahut në krahun dhe në mbështetjen tuaj. Duhet ta dini mirë se problemi dhe halli më i madh prej të cilit vuajnë popujt myslimanë dhe jo myslimanë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qeveria amerikane, duke qenë shteti më i fuqishëm në botë, angazhon të gjitha forcat, resurset dhe energjitë e saj për të grabitur pasuritë dhe të mirat

materiale të popujve të tjerë të botës që i nënshtrohen asaj. Amerika është armiku më i madh i popujve të shtypur dhe të nënshtruar të botës. Amerika nuk heziton të ndërmarrë llojet e ndryshme të sulmeve dhe të krimeve ndaj njerëzimit me qëllim mbrotjen e interesave të saj të mëdha. Amerika nuk heziton të shkatërrojë ç'gjen përpara më qëllim mbrojtjen e supremacisë së saj politike, ushtarake, ekonomike dhe kulturore ndaj të gjithë popujve të tjerë të botës, që zgjedhin t'i nënshtrohen asaj. Ajo i nënshtron popujt e varfër të botës nëpërmjet reklamës së dubluar prej sionizmit ndërkombëtar, duke e paraqitur atë si përhapëse dhe mbështetëse të lirisë dhe të demokracisë. Amerika, në bashkëpunim të plotë me kukullat e emëruara prej saj në vendet e ndryshme të botës, pi prej gjakut të popujve të shtypur dhe të varfër, sikur ta kishin vetëm ata dhe shërbëtorët e tyre tradhëtarë të drejtën për të jetuar.

O ju myslimanë, që jeni nisur për tek Shtëpia e Shenjtë e Allahut! O ju myslimanë që ia keni nënshtruar zemrat tuaja Krijuesit të Gjithësisë, lutjuni Allahut të Madhëruar të ndihmojë të gjithë ata popuj të nënshtruar dhe të skllavëruar që të jenë qëndrestarë në përballje me Amerikën, Fuqitë e mëdha dhe shërbëtorët e nënshtruar ndaj tyre."[24]

[24] Copëza fjalimesh të shkëputura prej thirrjeve të Imamit të nderuar, drejtuar haxhilerëve të drejtuar për në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, datë 2 të muajit Dhil Hixheh, viti 1400h.

Gjatë një fjalimi tjetër, ai u drejtohet pelegrinëve më një tjetër thirrje të rëndësishme dhe thotë :

"Një prej kushteve kryesore për të realizuar aspiratat tona të larta dhe të natyrshme njerëzore, të shpalosura te të gjitha ritualet tona adhurimore në Haxh, është unifikimi i fjalës së myslimanëve dhe i qëndrimeve të tyre, pavarësisht shkollave juridike islame, të cilave u përkasin, pavarësisht kombeve, gjuhëve, racave dhe ngjyrës së lëkurës. Ata duhet të unifikojnë qëndrimet e tyre, pavarësisht llojeve të ndryshme të diversitetit të trashëguar prej kohës së injorancës dhe paditurisë. Është prej kushteve themelore të qëndresës dhe të përballjes me armiqte e Islamit bashkimi i myslimanëve në të gjithë botën. Këta armiq kanë marrë një goditje të madhe prej Islamit në këtë shekull, ndaj e shohin atë si rrezikun më të madh që u kanoset interesave të tyre grabitqare globale. E vetmja mënyrë, që ata kanë në dipozicion për të eleminuar dhe për të dobësuar këtë pengesë të madhe është përçarja e myslimanëve dhe mbjellja e konflikteve të ndryshme në mesin e tyre, nëpërmjet shërbëtorëve të tyre të devotshëm. Shërbëtorët e tyre më të mëdhenj janë hoxhallarët e ulët, injorantë e smirxhinj që vrapojnë pas të mirave materiale të kësaj bote, që u kanë shërbyer historikisht pushtetarëve zullumqarë dhe janë vënë në shërbim të interesave të tyre nëpërmjet manipulimit të masave besimtare, në emër të Zotit dhe të fesë. Këta hoxhallarë apo "dijetarë" i kryejnë

shërbimet e tyre të mëdha në kohërat kur realizohen tubimet e mëdha adhurimore të myslimanëve, veçanërisht në kohën e Haxhit.

Është detyrë madhore dhe po aq e shenjtë sa Haxhi vetë, që myslimanët e mbledhur në këto tubime adhurimore të shenjta të reflektojnë dhe të shqyrtojnë problemet dhe hallet e myslimanëve të tjerë të shtypur në mbarë botën. Allahu i Madhëruar na ka njoftuar qartësisht dhe në mënyrë të prerë në Kur'anin Famëlartë se, prej qëllimeve të shumta të kryerjes së Haxhit është që myslimanët që vijnë atje të kenë përfitime të llojeve dhe të dimensioneve të ndryshme, krahas shpërblimit të marrë për adhurimet e tyre. E ku ka përfitim më të madh se prerja e dorës së lakmisë së grabitqarëve dhe largimi i asaj dore të zezë prej pasurive të myslimanëve?! Është detyrë e të gjithë myslimanëve që të ndjekin nga afër dhe me kujdes të imtësishëm punët, angazhimet dhe impenjimet e këtyre shërbëtorëve të armiqve të tyre. Është detyrë e tyre të analizojnë me kujdes të gjitha planet dhe strategjitë e këtyre hoxhallarëve dhe dijetarëve të shthurur që kanë për qëllim përçarjen e myslimanëve dhe zbatimin e planeve të armiqve të Islamit. Është detyrë e shenjtë e myslimanëve që të largojnë me shkelma të gjithë ata dijetarë që nuk pranojnë këshillat e tyre dhe nuk mbrojnë interesat e

myslimanëve, sepse këta janë më të poshtër se tiranët dhe më të ulët se padronët e tyre."[25]

Kur'ani Famëlartë

Nuk ka diskutim se Kur'ani Famëlartë është burimi kryesor i unitetit ndërmjet myslimanëve. Kjo për arsye të shumta:

a. Ai është Libri unifikues, sepse është libri i të gjithë myslimanëve.

b. Ai është rrënja kryesore e pemës së përbashkët islame dhe ajetet e nderuara në të cilat bëhet thirrje për t'u larguar prej ndarjes dhe përcarjes janë të shumta dhe të larmishme.

c. Shumë i rëndësishëm është fakti se Kur'ani Famëlartë nuk i është drejtuar një myslimani të vetëm, apo një lloji të vetëm të tyre, por u është drejtuar të gjithë myslimanëve të botës, pavarësisht përkatësive të tyre kombtare, racore, fisnore, kulturore, pavarësisht shkallës së tyre ekonomike apo ngjyrës së lëkurës. Kjo ka qenë njëra prej arsyeve madhore që e ka shtyrë Imam Khomeinin, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, t'u bëjë thirrje myslimanëve që të mos largohen kurrë prej Kur'anit dhe të konsultohen

[25] Shkëputur prej fjalimit të Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* drejtuar haxhilerëve (pelegrinëve) të drejtuar për në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut në Qabe, datë 1 e muajit Dhil Hixheh, viti 1406.

vazhdimisht me të. Nuk ka si të jetë ndryshe. Kur'ani Famëlartë drejton thirrje që buçet në veshët e myslimanëve ditën dhe natën dhe thotë:

﴿إِنَّ هَٰذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ﴾

"Vërtet, ky është besimi juaj, besimi i vetëm. E Unë jam Zoti juaj, prandaj më adhuroni Mua." [26]

Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"U kujtoj të gjithë haxhilerëve të nderuar, të cilët janë drejtuar për të kryer ritualin e shenjtë të Haxhit, që gjatë kryerjes së ritualeve adhurimore, gjatë qëndrimit të tyre në Mekën e Nderuar dhe në Medinen e Ndriçuar, të qetësojnë zemrat e tyre në vazhdimësi me Kur'anin Famëlartë. I këshilloj ata që të mos heqin dorë prej leximit të vazhdueshëm të Kur'anit gjatë ditëve të qëndrimit në vendet e shenjta, sepse ajo është platforma hyjnore e zbritur prej qiellit dhe Libër Udhëzimi. Duhet të jeni të vetëdijshëm dhe të besoni fuqimisht se gjithçka që lidhet me të shkuarën e myslimanëve, me të tashmen dhe me të ardhmen e tyre është pazgjidhshmërisht e lidhur me këtë Libër të Shenjtë Hyjnor."

Në një tjetër thirrje drejtuar haxhilerëve, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Është detyrë madhore dhe kërkohet prej të gjithë myslimanëve të botës, cilado qoftë përkatësia e tyre

[26] Surja Et-Teubeh, ajeti 92.

kombëtare, fisnore apo racore, që t'u nënshtrohen kërkesave dhe ligjeve të Allahut të Lartësuar. Është detyrë e tyre që të përballen me planet e errëta të pasuesve të djallit dhe të shërbëtorëve të tyre. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës që të përballen me platformat e djallit që kanë për synim zhdukjen e Islamit dhe shfarrosjen e tij prej Lindjes dhe prej Perëndimit. Është detyrë e tyre të përballen me shërbëtorët dhe mumjet që u shërbejnë planeve të tyre si skllevër të përulur. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës që t'i zgjasin njëri-tjetrit dorën e bashkimit dhe të vëllazërisë, sepse ato janë thelbi dhe esenca e udhëzimeve të Librit të tyre të Shenjtë, që është Kur'ani Famëlartë. Është detyrë e të gjithë besimtarëve myslimanë të botës që t'i përgjigjen thirrjes së Krijuesit të tyre që i fton ata të kapen fort pas litarit të Allahut. Pas atij litari që i ndalon ata të sulmojnë dhe të luftojnë njëri-tjetrin. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës, të cilët u janë drejtuar vendeve të shenjta për të kryer ritualet e tyre adhurimore të përfitojnë edhe prej dimensioneve shumë të rëndësishme politike të këtyre ritualeve, sepse Haxhi nuk është vetëm një ritual adhurimor, por është njëkohësisht një obligim adhurimor politik për çdo mysliman dhe myslimane, për çdo besimtar dhe besimtare për të identifikuar dhe diagnostifikuar sëmundjet e myslimanëve dhe për të gjetur kurën e duhur për ato sëmundje, brenga dhe vështirësi. Ato vende të shenjta nuk janë thjesht vende për t'u kryer rituale

adhurimore të ftohta, të thata, të pakumtimta dhe jashtë kontekstit kur'anor e profetik. Ato vende janë selitë e shenjta që duhet të shërbejnë për të mbrojtuar interesat e myslimanëve, kudo që ata ndodhen. Është e nevojshme që të gjithë myslimanët e botës të reflektojnë rreth urtësive dhe mesazheve të panumërta që dërgojnë respektivisht historia e Profetëve Ibrahim dhe Ismail, *(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dy ata!)*, si shprehje të dy simboleve më të mëdha të vetësakrifikimit dhe të flijimit të gjithçkaje të shtrenjtë në shërbim të kauzës më të madhe dhe qëllimit përfundimtar që është lartësimi i fesë së Allahut."

Njëkohësisht, Imami i nderuar konstaton me dhimbje se fatkeqsia dhe problematika më e madhe e myslimanëve është largimi i tyre prej mësimeve dhe udhëzimeve të Kur'anit Famëlartë. Lidhur me këtë problematikë, ai *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, shprehet kështu:

"Problemi më i madh i myslimanëve është se ata i kanë braktisur udhëzimet e Kur'anit Famëlartë dhe janë rreshtuar nën hijen e të tjerëve."

Ai thotë gjithashtu:

"Është shumë e rëndësishme që myslimanët të veprojnë sipas udhëzimeve të Kur'anit dhe sipas traditës së Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata duhet të mos heqin kurrë dorë prej Kur'anit Famëlartë, sepse aty flitet edhe për çështjet më të rëndësishme të dynjasë së tyre dhe të Ahiretit. Tek

udhëzimet e tij përfshihen të gjitha këshillat e nevojshme të lidhura me përsosmërinë e njeriut, edukimin dhe vlerën e tij."[27]

Duhet që myslimanët të jenë të kujdesshëm dhe të kuptojmë se më e rreziskhme se gjithçka u përmend më sipër, është përdorimi i Kur'anit për qëllime të liga, devijimi dhe deformimi i tij, duke e vënë atë, në shërbim të interesave të armiqve të Islamit. Ky është rreziku më i madh me të cilin mund të përballen Islami dhe myslimanët njëkohësisht. Kjo është njëra prej çështjeve më të rrezikshme, për të cilën Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka paralajmëruar dhe ka thënë:

"Fatkeqësia më e madhe që i ka goditur myslimanët konsiston në faktin se Libri i Shenjtë i Allahut, Kur'ani Famëlartë, konsiderohet pa asnjë lloj vlere për myslimanët. Ai shërben vetëm për ceremonitë e tyre mortore dhe ka vlerë vetëm në varreza. Kjo ndodh për arsye të botëkuptimeve dhe të përceptimeve të gabuara që i përhapin armiqtë grabitqarë e dashakeqës dhe miqt e tyre injorantë e të paditur për Kur'anin. Kështu ndodhte në të kaluarën. Kjo është fatkeqësisht gjendja edhe në ditët e sotme. Libri i Shenjtë i Allahut që duhet të shërbejë për të bashkuar myslimanët kudo ku ata gjenden nëpër botë. Në vend që Libri i Shenjtë i Allahut të shërbejë si kushtetutë për të rregulluar jetët e tyre, ai përdoret për t'i përçarë myslimanët dhe për t'i armiqsuar ata me njëri-tjetrin. Në

[27] "El Kelimatul Kisar", vëll 1.

këtë mënyrë, roli i tij kryesor ka pësuar ngrirje të plotë dhe nuk ka asnjë efekt në shoqëri.

Ne jemi krenarë dhe i gjithë populli ynë është krenar që i përket një shkolle dhe një fraksioni islam që i jep një rëndësi të veçantë zbulimit, përhapjes dhe mbrotjes së të vërtetave kur'anore të mëdha të mishëruara në thirrjen dhe ftesën tonë të vazhdueshme për unitet të të gjithë myslimanëve në mbarë botën, pavarësisht dallimeve të tyre të shumta. Ne jemi krenarë që mbrojmë ato të vërteta kur'anore që shkojnë edhe përtej myslimanëve dhe i bëjnë thirrje njerëzimit për t'u bashkuar nën flamurin e humanizmit dhe të njerëzores, si e vetmja mënyrë për të shëruar sëmundjet e mëdha të njerëzimit dhe për t'i çliruar ata njëherë e përgjithmonë prej llojeve të ndryshme të prangave që ua kanë lidhur duart, këmbët, mendjet, shpirtërat dhe zemrat e tyre. Shpëtimi i njerëzimit prej atyre prangave do të thotë orientimi i tij në mënyrë të paqtë drejt përjetësisë dhe çlirimi i njerëzimit prej formave të ndryshme të rrënimit, nënshtrimit, adhurimit të kotë si dhe prej formave e llojeve më të sofistikuara të tiranisë."[28]

Edhe pse të gjithë myslimanët e kanë shumë të qartë se Kur'ani Famëlartë është burimi i domosdoshmërisë së unitetit ndërmjet tyre, janë të shumta gjithashtu ajetet kur'anore, të cilat e nxisin myslimanin e pavëmendshëm dhe idiferent që të kthjellohet dhe të zgjohet. Është një

[28] Shkëputur prej një fjalimi të shkëlqesisë së tij *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)* duke folur rreth madhështisë së Kur'anit Famëlartë.

pafundësi ajetesh që vijnë për të ngacmuar ndërgjegjet e këtyre myslimanëve indiferentë dhe që flasin herë pas here rreth historive të luftës së Profetit të nderuar më idhujtarët femohues. Janë të shumta ajetet kur'anore, në të cilat flitet për betejat e myslimanëve me armiqtë e tyre, të cilat duhet të ndërgjegjësojnë qeniet e tyre. Këto ajete kur'anore vijnë për t'u bërë ftesë myslimanëve që të ngrihen në këmbë, të zgjohen prej gjumit të thellë në të cilin kanë rënë dhe të përballen me armiqtë e tyre dhe me armiqtë e Islamit. Për të qartësuar edhe më tej këtë aspekt, Imami i nderuar, *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*, thotë :

"Një prej përmbajtjeve të këtij Libri të ndritur dhe të shenjtë, është përshkrimi i idhujtarëve, femohuesve, i kundërshtuesve të së vërtetës, i atyre që kanë luftuar Profetët e nderuar, *(Paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!)*, përgjatë historisë. Është prej përmbatjes së Kur'anit Famëlartë sqarimi i gjendjes së këtyre njerëzve, përshkrimi i shkatërrimit të fundit të tyre të hidhur, siç është historia e Faraonit, e Karunit, e Nemrudit, e Shed'dadit, e ushtrisë së Elefatëve dhe e shumë të tjerëve prej kriminelëve femohues. Të gjithë myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm se te secila prej atyre historive ka mësime të mëdha dhe shumë urtësi. Tek secila prej atyre historive ka dije të mëdha për ata që mendojnë dhe meditojnë. Te kjo kategori tregimesh e historishë, të rrëfyera aq bukur me stilin e mahnitshëm kur'anor, përfshihen edhe çështjet e lidhura me kryetarin e djajve, me Iblisin e mallkuar. Pjesë e

këtyre rrëfimeve janë edhe betejat e ndryshme të Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, histori këto të mbushura me kuptime, me përmbajtje kur'anore të mëdha dhe me urtësi të jashtëzakonshme. Pjesë e këtyre rrëfimeve janë betejat e shokëve të Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, më qëllim zgjimin e myslimanëve prej gjumit të indiferencës dhe orientimin e tyre drejt luftës për të lartësusar Fjalën e Allahut të Madhëruar dhe të shkatërrimit të së keqës, të mohimit dhe të kotësisë."[29]

Personaliteti i më të nderuarit të Profetëve, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Personaliteti dhe figura e të Dërguarit të Allahut, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, janë sinteza e bashkimit dhe unifikimit për të gjithë myslimanët e botës, cilado qoftë përkatësia e tyre racore, apo kombëtare. Ai është Profeti i të gjithë ymeti. Të gjithë janë të bindur se Profeti i nderuar është Komandanti i Përgjithshëm i tyre. Ai është burri më i madh mbi tokë i veshur me cilësitë absolute prej Krijuesit të Gjithësisë. Ai i fton të gjithë myslimanët që të bashkohen me njëri-tjetrin. Kjo është mënyra më e mirë për t'u përballur me planet

[29] Burimi i mësipërm.

grabitqare të armiqve të tyre. Për këtë ka folur shpesh Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*. Po ofrojmë për lexuesin disa prej qëndrimeve të Imamit të nderuar. Ai, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë:

"Ndër qëllimet madhore të Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kanë qenë bashkimi i myslimanëve dhe i qëndrimeve të tyre, pavarësisht përkatësive të tyre dhe përhapja e adhurimit të Allahut të Vetëm në të gjithë vendet e botës. Prej qëllimeve më të mëdha të Profetit të Zotit është përcjellja e mesazhit të Njësimit, (Teuhidit) për cerekun e tokës së banuar prej njerëzve. Ky ka qenë misioni dhe preokupimi i tij më i madh. Ky mision nuk ka mundur të realizohet. Realizimin e tij e kanë penguar interesa madhore të mbretërve dhe të perandorëve, si dhe priftërinjtë hebrenj dhe të krishterë, të cilët e kanë parë thirrjen e Profetit dhe fenë e re me të cilën ai erdhi, si rrezik potencial për fetë e tyre. Frika e madhe e tyre dhe kërcënimi që përfaqësonte për ta feja e re, bënë që ata të luftojnë më të gjitha mënyrat përhapjen e saj. Kjo ka ndodhur në kohën e Profetit, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por kjo po ndodh edhe sot me të njëjtën skemë, me të njëjtin agresivitet dhe më të njëjtën formë.

Është detyrë e të gjithë mbretërve, sulltanëve dhe drejtuesve të vendeve islame, që të lenë mënjanë konfliktet dhe kundërshtitë e parëndësishme sezonale që

kanë me njëri-tjetrin. Ka vetëm një Islam që i bashkon të gjithë. Ka vetëm një dëshmi që i bashkon të gjithë. Dhe dëshmia është: "La ilahe Ilall Llah Muhammedun Rresulull Llah! Nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Madhëruar dhe se Profeti i nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Është detyrë e të gjithë drejtuesve dhe liderëve myslimanë që të ndjekin me përpikmëri të Dërguarin e Allahut në përpjekjet e tij për t'u përballur me këto sfida të mëdha. Është detyrë e këtyre liderëve që të mbajnë anën e Islamit dhe të ruajnë interest e myslimanëve kudo që ndodhen. Nëse drejtuesit e vendeve islame do të unifikojnë qëndrimet e tyre politike, nëse do të lenë mënjanë konfliktet dhe kundërshtitë e tyre të parëndësishme sezonale, nëse do të behën bashkë dhe do t'i shtrëngojnë fort duart e njëri-tjetrit, nuk ka dyshim se suksesi dhe fitorja do të jetë në anën e tyre. Statistikat thonë se numri i myslimanëve sot në botë është është 700 milionë banorë. Por 700 milionë njerëz të ndarë dhe të përçarë me njëri-tjetrin nuk kanë as vlerën e një milioni të vetëm të bashkuar. Të gjithë e dinë se një numër kaq i madh njerëzish të përçarë janë tërësisht të pavlerë. Sikur 200 milionë njerëz prej numrit të përgjithshëm të myslimanëve, apo 400 milionë prej tyre të kishin qenë të bashkuar me njëri-tjetrin, të bashkuar rreth fjalës së Teuhidit, të jeni të bindur se çifutët nuk do të mund ta ëndërronin Palestinën, e jo më ta kishin pushtuar. Kjo është

arsyeja kryesore përse Fuqitë e Mëdha i ndalojnë myslimanët që të bëhen bashkë."[30]

Nisur nga sa u tha më sipër, ftesa e më të nderuarit të Profetëve, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, u adresohet të gjithë myslimanëve të botës për të hequr dorë nga konfliktet, përçarjet dhe armiqësit. A ka më mirë se uniteti ndërmjet myslimanëve?! A mund të jetë diçka më e mirë se fjala unifikuese e Teuhidit, Njëhsimit, të cilën e ka mbjellë thellë zemrave të myslimanëve feja e tyre e pastër?!

[30] Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*, rreth bashkimit të umetit islam dhe mbështetjes së Palestinës.

KAPITULLI I TRETË

Imam Khomeini dhe përforcimi i themeleve të Unitetit Islam

Hyrje

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka shpenzuar energji të mëdha gjatë gjithë jetës së tij të bekuar në ndihmë dhe në funksion të bashkimit të myslimanëve dhe të unifikimit të vendimeve dhe qëndrimeve të tyre. Fushat e shumta në të cilat ai është përpjekur për të realizuar këtë qëllim madhor të tij dhe të mbarë myslimanëve e shndërrojnë atë në liderin më të madh që përcjell frymë unifikuese ndërmjet myslimanëve, që prej shekullit të njëzet e më pas. E si mund të jetë ndryshe?! Ai është Imami që ka nxjerrë fjalën "unitet" prej pluhurave të historisë dhe e ka integruar në fjalorin modern të komunikimit ndërmjet myslimanëve. Ai është njeriu që ka investuar gjithë jetën e tij për të bërë këtë fjalë të madhe dhe kuptimplotë, e cila është bërë pjesë e pandarë në tryezat e diskutimeve të dijetarëve dhe intelektualëve

myslimanë të kohëve moderne. Kjo fjalë kishte munguar në fjalorin e myslimanëve për shekuj me radhë. Ai është Imami i nderuar që e bëri këtë fjalë pjesë të pandarë të përditmërisë së myslimanëve të thjeshtë. Ai i ka përdorur të gjitha mënyrat e mundshme dhe të gjitha format që ka patur në dispozicion për t'i njoftuar myslimanët dhe për t'u treguar atyre se uniteti dhe bashkimi është e vetmja mënyrë dhe e vetmja rrugë që ata kanë për t'u shkëputur njëherë e përgjithmonë prej ditëve të zeza, prej zullumit, prej padrejtësisë e tiranisë. Uniteti është e vetmja formulë që mund t'i shpëtojë ata prej fatkeqësive të mëdha që ua kanë kurdisur atyre armiqtë e Islamit gjatë historisë. Shembulli më i madh dhe më i qartë lidhur me këtë është humbja e Palestinës dhe rënia e saj në duart e sionismit ndërkombëtar. Kur ndodhte kjo arabët dhe myslimanët shikonin gjithçka dhe nuk luanin as qerpikun për ta ndaluar një fatkeqësi të tillë. Pasiviteti i tyre ishte i tillë sa mendoje se arabët dhe myslimanët nuk inekzistonin. Për këtë Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, citohet të ketë thënë:

"Shumë prej qeverive të vendeve islamike i janë nënshtruar filozofisë së humbjes dhe të inferioritetit. Por jo vetëm kaq. Ata i kanë tradhëtuar popujt e tyre dhe kanë bashkëpunuar me armiqtë e Islamit dhe të myslimanëve, janë vënë në shërbim të planëve djallëzore të armiqve të myslimanëve dhe zbatojnë më përpikmëri të gjitha udhëzimet e tyre. Synimi i tyre kryesor është të krijojnë një

klimë konstante dhimbjesh, faktkeqsish dhe prapambetjeje mes myslimanëve. Plani më i madh i armiqve të Islamit dhe armiqve të myslimanëve ka qenë dhe vazhdon të jetë forcimi i pushtetit të Izraeilit mbi politikat, pasuritë dhe tokat e myslimanëve."[31]

Në një tjetër komunikim të tij Imami i nderuar citohet të ketë thënë:

"Po të ishin të unifikuara energjitë e arabëve dhe mundësitë e njëqind milion arabëve, amerikanët nuk do të mund të bënin asgjë".

Po a u forcuan themelet e ymetit Islam prej këtij Imami të madh?! Sa dhe si u ngacmuan ndërgjegjet e myslimanëve nga udhëzimet e këtij Imami të madh? A janë zgjuar ato prej gjumit të thellë në të cilin ishin zhytur nga këto mësime?!

Hapat më të rëndësishëm të ndërmarra prej Imam Khomeinit, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, nisin fillimisht me ringjalljen e njërit prej obligimeve më të mëdha të myslimanëve që deri në ditët e tij kishte qenë plotësisht jashtë çdo funksioni. Ky hap, është padyshim ringjallja e unitetit, si pjesa më e rëndësishme dhe fryma e ritualit obligativ të Haxhit. Ky është hapi madhor, i cili konsiston në distancimin e plotë shpirtëror dhe praktik prej idhujtarëve, femohuesve dhe të gjithë armive të Allahut (El-bera'a). Më pas, Imami i nderuar i orientoi myslimanët që të kthejnë shikimin nga Palestina dhe ta shpallin atë si

[31] Kudsi në mendimin e Imam Khomeinit *(Zoti qoftë i kënaqur me të!)*.

çështjen qendrore dhe më të rëndësishme të myslimanëve në mbarë botën dhe t'i japin asaj një prioritet të padikutueshëm. Nisur nga ky këndvështrim ai ka caktuar një ditë të veçantë për Kudsin. Në këtë ditë duhet të kujtohet çështjen madhore, qendrore, politike, shpitërore dhe fetare e tyre. Disa prej këtyre çështjeve do t'i sqarojmë në vijim, me ndimën e Allahut të Madhërishëm:

Distancimi prej idhujtarëve gjatë kryerjes së Haxhit

Për shkak të ndërhyrjeve të shumta të armiqve të Islamit përgjatë historisë, rituali obligativ dhe shumë i rëndësishëm i Haxhit është shndërruar në një ritual adhurimor rutinë. Ky ritual duhet të jetë manifestim i një dimensioni shumë të rëndësishëm politik islam. Por ai është shndërruar në një manifestim i dimensioneve turistike moderne. Zhveshja e këtij rituali kaq të rëndësishëm për myslimanët prej dimensionit të tij politik do të thotë zhveshja e tij prej të gjitha qëllimve dhe arsyeve për të cilat Allahu i Madhërishëm e bëri atë të obligueshëm për myslimanët. Armiqtë e Islamit të ndihmuar nga veglat e tyre kanë mundur dhe ia kanë dalë që t'i zbehin efektet dhe qëllimet madhore të këtij rituali madhështor, që përfaqëson njërin prej adhurimeve më të mëdha me dimensione politike.

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, e nuhati këtë rrezik të madh. Ai bëri të pamundurën që të rikthejë në kujtesën e myslimanëve dimensionin politik të këtij rituali madhështor obligativ të myslimanëve, siç është kryerja e Haxhit. Ky ishte një hap madhështor që u konkretizua me thirrjen e Imamit për të shpallur në mënyrë deklarative distancimin prej idhujtarëve, femohuesve dhe përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, si armiqtë më të mëdhenj të Islamit, të myslimanëve dhe të interesave të tyre. Imami i nderuar ka deklaruar qartë dhe në mënyrë të hapur se distancimi prej Fuqive Botërore të kufrit dhe të idhujtarisë është shtyllë prej shtyllave të Haxhit. Kjo është e vetmja mënyrë që Haxhi dhe adhurimet e kryera në të, të marrin formën e tyre të plotë. Lidhur me këtë aspekt Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* thotë:

"Shpallja e distancimit dhe e shkëputjes së plotë prej fuqive të errëta të kufrit dhe të idhujtarisë është një prej shtyllave më të rëndësishme të Njehsimit. Ajo është detyrë obligative dhe politike e Haxhit. Është e pamundur, madje një hipokrizi e vërtetë që të pretendosh se e do Islamin dhe myslimanët dhe, në të njejtën kohë, të mos distancohesh shpirtërisht dhe praktikisht prej idhujtarëve femohues, që përfaqësojnë njëkohësisht armiqtë më të mëdhenj të Islamit dhe të myslimanëve në të gjithë historinë.

Cila mund të jetë ajo Shtëpi, ai vend dhe ajo seli, që është më e pastër dhe më e Shenjtë se Qabeja e Shenjtë, në

të cilën mund të shpallet, të çertifikohet dhe të noterizohet përpara Audiencës Hyjnore një deklaratë që tregon distancimin prej të gjithë armiqve të Allahut dhe të fesë së Tij?! Kjo është Shtëpia e Shenjtë e Allahut në të cilën mund të hidhen themelet më të forta për t'i shpallur luftë formave dhe llojeve të ndryshme të shtypjes, tiranisë, padrejtësisë, shfrytëzimit, skllavërisë dhe poshtërimit njerëzor të formave dhe të natyrave të ndryshme. Ku ka vend më të përshtatshëm se Qabeja e Shenjtë, për të shembur njëherë e përgjithmonë zotat e rremë të ndërtuar pa vetëdije tek mendjet e besimtarëve duke realizuar kështu të plotë dhe me të gjitha dimensionet e saj thirrjen e Allahut të Madhëruar kur thotë: 'A nuk jam Unë Zoti juaj?' A ka vend më të Shenjtë dhe më të pastër se Qabeja e Bekuar për të ringjallur simbolikën më të madhe dhe më të rëndësishme politike të Profetit të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilën Allahu i Madhërishëm e përshkruan në Kur'anin Famëlartë kështu:

﴿وَأَذَانٌ مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ أَنَّ اللَّهَ بَرِيءٌ مِنَ الْمُشْرِكِينَ وَرَسُولُهُ﴾

"Ja shpallja e Allahut dhe dhe e të Dërguarit të Tij drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të Madh: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim dhe çdo lidhje shpirtërore me idhujtarët.'"[32]

[32] Surja "Et Teube", ajeti 3.

Të gjithë myslimanët e botës duhet ta kenë të qartë se ky distancim prej idhujtarëve dhe armiqve të Allahut është traditë e Profetit tonë të nderuar, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm gjithashtu se distancimi prej femohuesve dhe hipokritëve nuk është i kufizuar vetëm për ditët e Haxhit. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës që ta mbushin botën duke e demostruar dashurinë e tyre për Allahun e Madhërishëm, për të Dërguarin e Tij, për njëri-tjetrin dhe për të gjitha krijesat e njerëzimit që nuk i luftojnë myslimanët dhe nuk u shpallin atyre armiqësi as të fsheur e as të hapur. Detyrë tjetër madhore e tyre që ka shenjtëri të njëjtë me dashurinë për Allahun e Madhëruar dhe të Dërguarin e Tij, është distancimi i plotë dhe shpallja e urrejtjes dhe e armiqsisë për të gjithë ata që e luftojnë Allahun, të Dërguarin e Tij dhe të gjithë myslimanët kudo që ata ndodhen. Është detyrë e myslimanëve që të mos dëgjojnë pëshpëritjet e ngatërrestarëve dhe të devijuarve, që kanë për qëllim të deformojnë kuptimet madhore të fesë së tyre dhe të obligimeve të zbritura prej Allahut të Madhëruar. Është detyrë e besimtarëve të ndershëm, të jenë vigjilentë dhe të mos ua venë veshin injorantëve dhe të paditurve të devijuar që kanë për qëllim t'i nxjerrin ata prej shinave të frymës së himnizimit të Njehsimit të Shenjtë dhe gjithëpërfshirës."[33]

[33] Haxhi në mendimin e Imam Khomeinit (El-Haxh Fii Fikril Imam

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, gjykon se shpallja e distancimit prej idhujtarëve dhe prej femohuesve në mënyrë deklarative gjatë kryerjes së këtij riti obligativ të myslimanëve të mbledhur nga të katër anët e globit, është një mundësi e mirë për të zgjuar ndër ta energjitë e plogështuara prej gjumit të thellë. Ky event i rëndësishëm adhurimor i myslimanëve, është një mundësi e jashtëzakonshme për të gjallëruar dhe për të vënë në zbatim energjitë e tyre të mëdha në shërbim të myslimanëve. Kjo është mundësi e rëndësishme për t'u rikujtuar atyre armiqtë më të mëdhenj të cilët thurin pandërprerë plane për t'i nënshtruar dhe për t'i grabitur ata. Imami i nderuar, vijon më tej dhe thotë :

"Sa herë që u bëjmë thirrje myslimanëve që të shpallin në mënyrë deklarative armiqësinë dhe distancimin e tyre prej femohuesve, kemi patur dhe vazhdojmë të kemi si qëllim dhe synim kryesor zgjimin e myslimanëve dhe çlirimin e energjive të akumuluara të mbarë botës islame. Shpreh bindjen time të madhe dhe besimin tim të plotë se, më ndihmën e Allahut të Madhëruar dhe me ndihmën e brezave të ardhshëm që i kanë lidhur zemrat e tyre me Kur'anin, ky qëllim madhor dhe i shenjtë do të realizohet një ditë. Jam thellësisht i bindur gjithashtu se, me lejen e Allahut të Madhëruar, do të vijë ajo ditë kur myslimanët në të gjithë botën do të ngrihen dhe do të ngrenë zërin e tyre kunër padrejtësive

Khomeini), Shoqata islame Kulturore "El-Mearef".

dhe zullumqarëve të botës. Do të vijë një ditë kur myslimanët do t'i tregojnë botës se zullumqarët, Fuqitë e Mëdha dhe bishtat që u shërbejnë projekteve dhe planeve të tyre për interesa të ulëta meskine, janë krijesat më të pështira dhe më të urryera që mban mbi kurrizin e saj kjo tokë.

Thirrja jonë për t'u distancur prej idhujtarëve, femohuesve dhe armiqve të Islamit është thirrja e të gjithë atyre popujve të botës që gjenden nën sundimin e Amerikës. Thirrja jonë përfaqëson thirrjen e popujve të ndryshëm të botës që e kanë të pamundur të shmangin praninë autoritare, nënshtruese dhe diktuese të Amerikës në vendet e tyre. Thirrja jonë përfaqëson, dhimbjen, poshtërimin, përuljen dhe nënshtrimin ndaj armikut më të madh të Islamit dhe të myslimanëve. Thirrja jonë largon prej tyre poshtërimin, nënshtrimin dhe padrejtësinë që shkakton pamundësia dhe pafuqia e tyre për të jetuar pa prangat e të huajve shtypës e zullumqarë. Thirrja jonë përfaqëson dhimbjen e madhe dhe aspiratat e të gjithë atyre njerëzve dhe popujve për të jetuar dhe për të vdekur të lirë."[34]

Në një tjetër qasje të tij Imami i nderuar thotë:

"Të shumtë janë myslimanët e ardhur prej vendeve të ndryshme të botës, për të kryer ritualin obligativ të Haxhit në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut të Madhëruar. Ata shkojnë në Haxh për të përmbushur këtë detyrim të madh

[34] Burimi i mëprashëm.

të jetës së tyre ndaj Allahut të Madhëruar. Të shumtë janë ata, të cilëve Allahu ua mundëson vizitën e Shtëpisë së Tij të Shenjtë vijnë për të marrë pjesë në konferencën e përvitshme dhe më të madhe të myslimanëve në të gjithë botën, në ditë të shenjta dhe në një vend të shenjtë. Kur besimtarët i përgjigjen thirrjes së Allahut të Madhëruar dhe ftesës së Tij të Shenjtë për të qenë të pranishëm në Haxh është detyrë madhore dhe shumë e rëndësishme e tyre që, përveç dimensionit adhurimor të këtij rituali madhështor, të përfitojnë edhe prej dimensionit të tij politik. Nuk mundet dhe nuk duhet që myslimanët të përqendrohen vetëm tek çështjet dhe dimensionet sipërfaqësore të adhurimeve. Ky është një gabim i madh në të cilin ata kanë rënë dhe bien vazhdimisht. Të gjithë njerëzit e dinë se nuk ka individ dhe as shtet në botë që të ketë mundësi të organizojë një konferencë dhe një takim të përvitshëm të këtyre përmasave. Janë urdhërat e Allahut të Madhëruar dhe dispozitat e Tij ato që kanë mundësi të ndikojnë në ogranizmin e një konference të përvitshme të këtyre përmasave. Fatkeqsisht, jemi të detyruar ta pranojmë se myslimanët nuk kanë mundur të përfitojnë sa duhet prej kësaj fuqie të jashtëzakonshme organizative të Allahut. Ata nuk kanë mundur kurrë që ta venë një konferencë të këtyre përmasave në shërbim të interesave të Islamit dhe të myslimanëve kudo që ata janë. Të shumta janë gjithashtu, dimensionet politike të përfaqësuara tek mbledhjet e myslimanëve, tek grumbullimet e tyre periodike qofshin

ato ditore, javore apo vjetore, siç janë, për shembull, namazi i xhumasë dhe takimi solemn, madhështor dhe shumë i rëndësishëm i Haxhit. Një prej qëllimeve madhore të këtyre takimeve dhe grumbullimeve periodike të myslimanëve është konsultimi i çështjeve të tyre politike, ekonomike dhe shoqërore. Sa i përket takimeve në Haxh, mund të themi me bindje të plotë se takimi i dijetarëve të Islamit, i mendjeve të tyre të ndritura dhe i intelektualëve të ndryshëm të ardhur nga e gjithë bota mund të konsultojnë me sukses hallet, shqetësimet dhe mund të japin zgjidhje të caktuara për çështjet e tyre më të rëndësishme. Është plotësisht e mundur që këto receta dhe këto përfundime të dala prej këtyre takimeve dhe konsultimeve në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut të jenë melhem dhe rekomandime kurative për hallet dhe problemet e myslimanëve secili në vendin ku jeton dhe banon."

Një prej specifikave të këtij rituali adhurimor konsiston në faktin se ai nuk është i lidhur me një kohë të caktuar duke përjashtuar kështu kohët e tjera. Ai është një ritual adhurimor për të gjithë besimtarët dhe myslimanët që kanë mundësi financiare dhe shëndetësore për ta kryer në çdo kohë kur ta kenë të mundur.

Ky është një ritual që nuk ka për t'u ndalur kurrë, për sa kohë ekzistojnë myslimanët dhe për sa kohë Haxhi të jetë obligim i pandryshueshëm. Lidhur me këtë aspekt,

Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë kështu:

"Nuk ka dyshim se kjo thirrje për t'u distancuar prej idhujtarëve dhe femohuesve, nuk është e lidhur me një kohë dhe një vend të caktuar. Ky është një nen i pazëvendësueshëm në Kushtëtutën e përjetshme të zbritur prej Allahut të Madhëruar. Edhe në rast se femohuesit dhe idhujtarët shuhen në vendet e Hixhazit, (vendeve të Gjirit), ky mbetet një nen kushtetues i Allahut i pazëvendësueshëm, efektet e të cilit nuk zhbëhen dhe nuk mund të humbasin kurrë, sepse direktivat dhe dispozitat e Zotit nuk janë të lidhura me një vend dhe më një kohë të caktuar. Ky grumbullim i përvitshëm i myslimanëve nga e gjithë bota ka dimensione adhurimore dhe i tillë do të mbetet sa të ketë jetë mbi Tokë. Kjo është arsyeja kryesore përse imamllarët kanë vendosur një ditë të caktuar për të mbajtur zi dhe për të kujtuar padrejtësinë e ushtruar ndaj zotërinjve të njerëzimit deri në Ditën e Gjykimit. Kjo është mënyra më e mirë për të ngritur lart thirrjen e fuqishme të anëtarëve të familjes së Profetit, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mbi të cilët është ushtruar pabesi dhe padrejtësi nga më të pashembulltat. Kjo është mënyra më e mirë për të mbajtur të gjallë kujtimin e kësaj dhimbjeje të madhe dhe të kësaj padrejtësie të ushtruar mbi krijesat më të pastra të

njerëzimit prej anëtarëve të dinastisë emevite, (mallkimi i Zotit qoftë mbi ata), edhe pse tashmë janë zhdukur."[35]

Palestina si çështja qendrore e myslimanëve

Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, i ka orientuar myslimanët drejt njërës prej çështjeve më të rëndësishme të myslimanëve. Ai është përpjekur me të gjitha mundësitë dhe hapësirat që ka patur në dispozicion që të ngrejë njërën prej problematikave më të rëndësishme të myslimanëve, njërën prej plagëve të tyre më të mëdha, çështjen palestineze. Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, është i mendimit së çështja palestineze është çështja më e rëndëishme e myslimanëve që ka dhe duhet të ketë prioritet ndaj të gjitha çështjeve të tjera të ymetit islam. Kjo është çështja më e madhe dhe më e rëndësishme që duhet të preokupojë liderët dhe drejtuesit e të gjithë botës, veçanërisht të atyre myslimanë. Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, e paraqet shmangien e kësaj çështjeje nga agjendat e kryetarëve të shteteve islame si sëmundjen më të madhe të atyre vendeve. Në rast të kundërt, nëse keta liderë shtetesh do të zgjidhnin çështjen e rëndësishme palestineze, nëse do ta shkulnin njëherë e përgjithmonë Izraelin, atë gjëndër kancerogjene të shfaqur në gjeografinë e myslimanëve, sigurisht që do të

[35] Burimi i mëparshëm.

mund të shpëtonin prej pjesës më të madhe të halleve dhe të problemeve të tyre. Kjo është një çështje plotësisht e mundur. Mjafton të ekzistojë dëshira dhe vullneti për ta realizuar një mision të tillë. Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, na këshillon:

"Është një çështje e rëndësishme, e cila nuk u jep përgjigje shumë pyetjeve. Të gjitha vendet islame e dinë se cili është problemi i tyre më i madh, se cili është burimi i problemeve dhe i ngatërresave të tyre, se cila është dora e fshehtë që mbjell përçarje, luftëra dhe armiqësi ndërmjet tyre. Ata e kanë të qartë se fundi i përçarjes dhe i luftës do të sjellë dobësimin e vazhdueshëm të tyre. Ata e dinë se Izraeli është armiku më i madh i myslimanëve kudo që ata janë, ashtu siç e dinë se po të bashkohen, Izraelin do ta mposhtnin.

Por është e pabesueshme kur mendon se myslimanët i dinë të gjitha këto dhe përsëri nuk bëjnë asnjë hap për të evituar këtë të keqe të madhe, por vazhdojnë të qëndrojnë kokëulur dhe të poshtëruar përballë saj. Kjo është logjikisht e pashpjegueshme. Si është e mundur që myslimanët, megjithëse e dinë se po të bashkohen të gjithë, do ta gjejnë shpëtimin dhe përsëri vijojnë të qëndrojnë pa bërë asgjë?! Çfarë i ndalon myslimanët që të bashkohen dhe të shkatërrojnë kurthet e armiqve të tyre?! Kur do të zgjidhet kjo gjëegjëzë e madhe tallëse?! Cili është ai që mund të japë një përgjigje të plotë për të?! Kush tjetër, përveç qeverive islame dhe popujve myslimanë mund ta

zgjidhin këtë çështje në mënyrë përfundimtare?! Të gjithë ata myslimanë që e kanë një përgjigje për këtë, janë të lutur të na e ofrojnë atë. Dijeni mirë, (dhe ju e dini këtë) se ata që e ndalojnë bashkimin e Iranit me Irakun janë duart e huaja, të cilat kanë synime grabitqare, kanë dëshirë të vjedhin pasuritë tuaja. Këtë bashkim e kanë ndaluar dhe vazhdojnë ta ndalojnë të gjitha ata që duan të thithin gjakun tuaj, duan të grabisin pasuritë e mëdha të nëntokës dhe të mbitokës suaj. Të njëjtat duar ndalojnë bashkimin e Iranit me Egjiptin. Të njëjtat duar ndalojnë bashkimin e Iranit me Turqinë. Qëllimi tyre më i madh është që të mos realizohet ky bashkim i madh, ky bashkim i fjalës, i zemrave dhe i qëndrimeve. Kjo, në fakt nuk është detyra juaj. Kjo është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e krerëve dhe e liderëve të shteteve tuaja, të cilët duhet të ulen me njëri-tjetrin. Është detyrë e tyre që të diskutojnë, të studiojnë, të miratojnë dhe të implementojnë strategjitë e nevojshme për të siguruar bashkimin, forcimin dhe mbrotjen e kufijve dhe të ineteresave të tyre. Është detyre e liderëve të myslimanëve që intesifikojnë qëndrimet e tyre përballë armiqve të jashtëm. Është detyrë e liderëve myslimanë të që mbrojnë interesat e myslimanëve. Po të kishin qenë të bashkuar shtetet islame, nuk do të mundej një grusht çifutësh mashtrues dhe hajdutë që të ndajnë për më shumë se dhjetë vite miliona myslimanë, por shtetet islame bëjnë sehir, organizojnë mbledhje e takime zie e ngushëllimi. Po të ishin të bashkuara vendet islame, nuk do të mundeshin

dot një grusht çifutësh hajdutë të bënin ligjin dhe të vendosin për gjithçka?! Po të ishin vendet islame të bashkuara dhe po të kishin qëndrimet politike të unifikuara, nuk do të ishte e mundur që një grusht hebrenjsh hajdutë të grabisin Palestinën! Si është e mundur që një grusht çifutësh hajdutë të përzënë vëllezërit tanë palestinezë prej tokave dhe vendbanimeve të tyre dhe askush prej shteteve islame nuk bën zë?!"

Për problemet që u përmendën më sipër Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka qenë i mendimit se problemi më i madh qëndron te vetë myslimanët, të cilët tregohen të dobët dhe të pafuqishëm përtej çdo limiti për të kërkuar të drejtat e tyre. Njëra prej të drejtave më të mëdha dhe më të shenjta të myslimanëve është e drejta e tyre për t'ua rikthyer territoret e grabitura palestinezëve.

Edhe për këtë çështje Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, u drejtohet me thirrje të drejtpërdrejtë të gjithë pushtetarëve që kanë nën sundimin e tyre pasuritë marramendëse të myslimanëve. Ai u tregon atyre hapat e domosdoshëm që duhet të ndërmarrin për të rifituar të drejtat e tyre të humbura. Lidhur me këtë citohet që Imami i nderuar të ketë thënë:

"Çështjet për të cilat do të flas janë të ditura prej jush, por unë po i sjell sërish në vëmendjen tuaj, thjesht për t'jua kujtuar edhe njëherë. Të gjithë liderët myslimanë janë të vetëdijshëm dhe i kanë të qartë hapat që duhet të ndërmarrin për të kthyer të drejtat e popujve të tyre, por

më parë është e nevojshme që të ulen me njëri-tjetrin dhe të lenë mënjanë konfliktet e tyre te vogla. Islamin e keni në mesin dhe në duart tuaja. Është e nevojshme që ta dinë të gjithë mbretërit, liderët, kryetarët e shteteve, presidentët e republikave, kryepleqtë dhe paria e urtë e secilit popull, njerëzit me pozita të larta islame të popujve myslimanë se këto pozita të larta në të cilat i ka vendosur Allahu i Madhëruar janë një përgjegjësi e madhe për ta. Nëse dikush zgjidhet në krye të një populli, ky nuk është një privilegj i madh. Para së gjithash, kjo është një përgjegjësi e madhe. Këta njerëz janë përgjegjës përpara Allahut të Madhëruar për jetët e popujve të tyre. Ata janë përgjegjës për të gjitha ndodhitë që mund t'u ndodhin atyre. Të huajt ua kanë nevojën atyre! Por çudia më e madhe është se popujt myslimanë të Lindjes zotërojnë pasurinë më të madhe të botës, por vetë ata nuk kanë asgjë në dorë, nuk i kontrollojnë pasuritë e tyre. Shtete e ndyshme të botës zhvillohen pikërisht ngaqë kontrollojnë pasuritë e popujve myslimanë të Lindjes, mineralet e vyera dhe naftën. Të gjitha këto pasuri gjenden në tokën tuaj dhe duhet të jenë në duart tuaja.

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar. Iraku është plot me naftë. Irani është plot më naftë. Kuvajti është plot me naftë. Vendet e Hixhazit janë të mbushura me naftë. E gjithë kjo pasuri e madhe dhe e rëndësishme botërore gjendet në duart tuaja. Të huajt duhet të puthin duart dhe këmbët tuaja që të arrijnë tek ato pasuri. Ata

duhet të paguajnë shtrenjtë për t'i blerë këto pasuri prej jush. Prandaj prej jush kërkohet që të mos u luteni dhe të mos u nënshtroheni atyre. Unë i lutem Allahut të Madhëruar që ju të mos jeni prej atyre që luten e nënshtrohen. Ata duhet t'ju luten dhe t'ju nënshtrohen juve, sepse pasuria është në duart tuaja, në duart e myslimanëve. Problemi qëndron në faktin se disa shtete perëndimore mundën t'i mashtrojnë disa shtete të myslimanëve. Është fatkeqësi e madhe që në rastin e myslimanëve ndodh e kundërta. Ata janë të nënshtruar ndaj vendeve të huaja dhe u luten, u nënshtrohen dhe u përgjërohen atyre që të mund të gëzojnë pasuritë e veta. Në fakt, kjo është një çështje e paimagjinueshme që e bën të domosdoshme minimalisht, një keqardhje të madhe."

Nga sa u diskutua më sipër mund të themi se mungesa e unitetit mes myslimanëve dhe paaftësia e liderëve të shteteve islame për të unifikuar qendrimet ndërmjet shteteve respektive, mungesa e plotë e përgjegjësisë për fatkeqësitë dhe vuajtjet e myslimanëve, mungesa e përgjegjësisë ndaj mbrojtjes së Islamit dhe të dispozitave të tij, largimi nga Kur'ani dhe të tjera fatkeqësi të ngjashme e bëjnë të pamundur që liderët myslimanë të kontrollojnë dhe të zotërojnë fatet e tyre dhe të popujve që i qeverisin. Duhet ta mendoni mirë se bashkimi dhe uniteti juaj është e vetmja mënyrë, e vetmja rrugë që të riktheni krenarinë dhe fatet e myslimanëve në duart e tyre. Nëse

reflektoni seriozisht rreth këtyre kuptimeve të mëdha, pa më të voglin dyshim, keni për të qenë të parët e botës.

Nuk ka asnjë dyshim se e gjithë bota do ju nënshtrohet, nëse njiheni me Islamin e vërtetë dhe meditoni thellësisht. Nuk ka asnjë dyshim se premtimi i Allahut të Madhëruar është një e vërtetë e madhe që nuk ka askush fuqinë ta tjetërsojë. Allahu i Madhëruar ka premtuar në Kur'anin Famëlartë dhe ka thënë: **"Më të vërtetë, e gjithë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve"**.

Duke e marrë në konsideratë problematikën për të cilën u diskutua më sipër dhe bazuar mbi këshillat e Imamit të ndjerë, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, Republika Islamike e Iranit e ka vendosur mbështetjen e çështjes palestineze në krye të prioriteteve të saj. Pjesë e kësaj liste të prioriteteve është edhe gjendja e unitetit mes vendeve islame. Për këtë, Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, thotë :

"Shprehim gadishmërinë tonë të plotë për të mbrojtur Islamin dhe pavarësisne e shteteve islame. Programi ynë dhe axhenda jonë janë islame. Programi ynë është programi i Islamit. Qëllimi ynë madhor është unifikimi i qëndrimeve të myslimanëve dhe bashkimi i shteteteve islame. Synimi ynë madhor është realizimi, nënshkrimi dhe zbatimi në realitet i aktit të madh të vëllazërisë islame me të gjitha grupimet e myslimanëve anembanë botës. Prej synimeve tona madhore është

bashkimi i shteteve të myslimanëve në të gjithë botën dhe të gjithë bashkë të qëndrojmë të vensodur përballë planëve të errëta dhe grabitqare të sionizmit ndërkombëtar dhe të Izraelit. Prej synimeve dhe qëllimeve tona madhore është bashkimi i myslimanëve në të gjithë botën dhe përballja me planet e fuqive grabitqare imperialiste, të cilat kanë për synim t'na nënshtrojnë, t'na grabisin pasuritë dhe t'na lenë të zhytur në llum, në mjerim, në varfëri dhe në prapambetje. Shpesh dëgjojmë thirrjet mashtruese për zhvillim dhe prosperitet të atyre vendeve, por thirrjet e tyre rrëzohen, hidhen poshtë dhe përgënjeshtrohen menjëherë prej fytyrave të zverdhura të popujve të botës së shtypur që gjenden të zhytura në varfëri, uri e mjerim. Ne ndiejmë dhimbje të madhe sa herë përballemi me këto të vërteta të mëdha dhe të hidhura. Dhimbje të madhe ndiejnë edhe dijetarët e ndershëm të Islamit sa herë që përballen me këtë tablo të errët. Në qoftë se e gjitha kjo që ne themi dhe mendojmë quhet prapambetje, atëherë le të jemi të prapambetur! Në qoftë se e gjitha kjo është prapambetja jonë, atëherë na lejoni të jetojmë si të prapambetur të tillë."

Dita Botërore e Kudsit

Kjo çështje e madhe konsiderohet si njëra prej çështjeve kryesore të mysliamëve. Meqenëse kjo është një çështje që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtjë në bashkimin dhe unifikimin e myslimanëve, u vendos që Dita Botërore e Kudsit, të jetë në xhumanë e fundit të muajit Ramazan të çdo viti. Kjo ditë u akordua prej Imam Khomeinit, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, vetëm katër muaj pas themelimit të Republikës Islamike të Iranit, në korrik të vitit 1979. Kjo tregon rëndësinë që i jepte kësaj çështjeje Imami i nderuar, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*.

Në tekstin e deklaratës së kësaj shpalljeje thuhet kështu:

"Njoftoni të gjithë myslimanët e botës dhe bëjuani atyre me dije se xhumaja e fundit e muajit Ramazan të çdo viti, që i bie të jetë pjesë e Natës së Kadrit dhe që mund të jetë përcaktuese dhe vendimtare në të ardhmen e Palestinës, do të jetë Dita Botërore e Kudsit. Ftojini myslimanët që nëpërmjet Unionit Botëor të Myslimanëve të shpallin mbrojtjen e të drejtave ligjore të popullit mysliman palestinez."[36]

Lidhur me rëndësinë dhe mesazhet që mbart Dita Botërore e Kudsit, Imami i nderuar *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, ka thënë:

[36] Kudsi në mendimin e Imam Khomeinit, Shoqata Islame "El-Mearef"

1. **Ajo është Dita e mobilizimit të përgjithshëm të myslimanëve.**

"Në të vërtetë, Dita Botërore e Kudsit ka qenë një ditë për mobilizimin e mbarë botës islame."

2. **Dita e të dobtëve.**

"Shpresoj që kjo Ditë e madhe dhe e rëndësishme të jetë një ditë në të cilën hidhen themelet për themelimin e partisë së njerëzve të dobët, të shtypur dhe të vobektë të mbarë njerëzimit. Shpresoj shumë që të themelohet një parti e njerëzve të dobët dhe të vobektë në botë."

3. **Dita e Islamit dhe e Qeverisë së tij.**

"Dita Botërore e Kudsit nuk është një ditë që lidhet vetëm me Palestinën. Në të vërtetë ajo është Dita e Islamit dhe Dita e Qeverisë islame. Kjo është një Ditë në të cilën duhet të valëvitet flamuri i Qeverisë islamike të Iranit në të gjithë botën."

4. **Kjo është Dita e të Dërguarit të Allahut,** *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)***.**

"Ditën Botërore të Kudsit, thotë Imami i nderuar, unë e konsideroj si Ditën e Islamit dhe Ditën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dhe kjo Ditë duhet të shërbejë për të

mobilizuar të gjithë myslimanët e botës për t'i nxjerrë ata prej izolimit në të cilin i kanë futur me dhunë."[37]

Kjo thirrje e Imamit të nderuar ka patur një jehonë të madhe në të gjithë botën islame dhe është pritur me shumë entuziazëm. Për këtë arsye myslimanët e të gjitha anëve të globit e festojnë dhe e përkujtojnë me dashuri Ditën Botërore të Kudsit në xhumanë e fundit të muajit Ramazan të çdo viti. Kjo është tashmë një Ditë shumë e rëndësishme e cila festohet në forma dhe manifestime të ndryshme.

Përfundim:

Uniteti mes shtresave dhe kategorive të ndryshme të myslimanëve, është njëra prej çështjeve më të rëndësishme të myslimanëve. Ajo mund të jetë çështja më e rëndësishme dhe themeli kryesor mbi të cilin mund të ndërtohet çdo lloj zhvillimi i mundshëm i tyre. Uniteti dhe bashkimi janë thelbi dhe themeli i të gjitha strategjive që kanë për synim kthimin e të drejtave të tyre të humbura dhe të nëpërkëmbura. Ai është muri i madh që mund të ndalojë shtrirjen e mëtejshme të arrogancës ndërkombëtare ndaj të drejtave të myslimanëve. Nisur nga sa është thënë dhe është cituar më sipër, mund të themi se, nëse myslimanët do të ishin kapur fort pas këshillave të Imamit

[37] Burimi i mëparshëm.

të nderuar, do të zbulonin thellë tyre shpirtin e Njëhsimit, të unitetit dhe thelbin e ineteresave të myslimanëve, kudo që ata ndodhen në botë.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve që asnjëherë të mos heqin dorë prej udhëzimeve të Kur'anit Famëlartë. Ai na bën thirrje natë e ditë, që të mblidhemi, të bashkohemi fort pas njëri-tjetrit, sepse kjo është e vetmja mënyrë për t'i shpëtuar shtypjes, poshtërimit dhe nënshtrimit nga të huajt. Kjo është e vetmja mënyrë për të fituar mundësitë për të reaguar.

Është detyrë madhore e myslimanëve që të mos shpërdorojnë asnjë mundësi, asnjë rast, cilido qoftë ai, për të bashkuar fjalën e tyre dhe për të unifikuar qëndrimet me njëri-tjetrin. Rasti më i volitshëm për të realizuar këtë mund të jetë Muaji i Madhërueshëm i Ramazanit, Dita Botërore e Kudsit, ose Muaji i Unitetit Islam që ndodh në muajin Rebiul Euel, ose në ditët e bekuara të Haxhit. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të jenë vigjilentë ndaj planeve djallëzore të armikut, i cili ruan dhe analizon me kujdes çdo lëvizje që bëjmë ne.

I lutemi Allahut të Madhëruar që të na mundësojë ne që të punojmë dhe të veprojmë sipas rrugës që e ka projektuar Imam Khomeini me mendimet e tij të ndritura. I lutemi Allahut të na mundësojë ne ta ndjekim rrugën e Imam Khomenit, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, i cili e ka

vënë jetën e tij të bekuar në funksion të bashkimit të myslimanëve dhe në shërbim të ngritjes lart të Flamurit të Islamit në të gjitha cepat e botës. Allahu u përgjigjet lutjeve dhe thirrjeve të sinqerta. Në përfundim, si gjithmonë, falënderimet më të përzemërta ia dedikojmë Allahut të Madhëruar që na ndihmoi të përgatisim këtë libërth.

Shoqata Kulturore Islame "El-Mearef"

PËRMBAJTJA

Parathënie.....5
KAPITULLI I DYTË.....7
Rëndësia e Unitetit dhe rrënjët e tij.....7
Imam Khomeini, *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, promovues dhe lider i Unitetit.....8
Rrënjët kur'anore të Unitetit Islam.....11
Uniteti Islam në traditën e nderuar profetike.....18
Heretizimi (Et-Tekfiir).....18
Vëllavrasja.....20
Rreziqet e përçarjes.....23
KAPITULLI I DYTË.....27
Format e Unitetit dhe shtyllat e tij.....27
Hyrje.....27
Haxhi (pelegrinazhi) dhe Uniteti i myslimanëve.....31
Armiku i përbashkët i myslimanëve dhe i të shtypurve....36
Kur'ani Famëlartë.....43
Personaliteti i më të nderuarit të Profetëve, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....50
KAPITULLI I TRETË.....54
Imam Khomeini dhe përforcimi i themeleve të Unitetit....54
Hyrje.....54
Distancimi prej idhujtarëve gjatë kryerjes së Haxhit.....57
Palestina si çështja qëndrore e myslimanëve.....66
Dita Botërore e Kudsit.....74
Përfundim.....76

اسم الكتاب: **الوحدة الإسلامية في فكر الإمام خمينى**

المترجم: **الحاج ولنت مريا**

التدقيق: **صبريه فزا**

التصحيح الأدبي: **اسعد بونغوري**

التصحيح اللغوي: **ويولسا كاراي**

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: **صبريه فزا**

ناشر: **جمعية النسيم – تيرانا – ألبانيا**